

# Udhëzues Për Rishikimin E Një Kuadri Ligjor Për Zgjedhjet



OSBe

ODIHR

# UDHËZUES PËR RISHIKIMIN E NJË KUADRI LIGJOR PËR ZGJEDHJET



Varshavë  
Janar 2005



# PËRMBAJTJA E LËNDES

I. HYRJE .....	6
II. BAZA E STANDARTEVE DHE QËNDRIMI I ANALISTIT .....	7
A. Burimet themelore të standarteve minimale .....	7
B. Burimet plotësuese .....	7
C. Qëndrimi i përgjithshëm i analistit .....	8
D. Respekti .....	8
E. Rëndësia e madhe e përkthimeve të sakta .....	9
F. Përgatitja .....	9
G. Klasifikimi i rekomandimeve sipas përparësisë .....	9
H. Theksoni ligjshmërinë ku të jetë e mundur .....	9
I. Shpjegoni arsyen e rekomandimit .....	10
J. Detaje më të hollësishme .....	10
III. STRUKTURA E KUADRIT LIGJOR .....	11
A. Përdorimi dhe vlera e ligjit të shkruar .....	11
B. dispozitat kushtetuese .....	11
C. Legjislati i përgjithshëm i zgjedhjeve kundrejt atij të posaçëm .....	12
D. Legjislati zgjedhor kundrejt legjislativëve të llojeve të tjera .....	14
E. Legjislati zgjedhor kundrejt udhëzimeve të komisionit Qendror të zgjedhjeve .....	14
F. Shtrirja e analizës .....	15
IV. SISTEMI ZGJEDHOR .....	17
A. Zgjedhja e sistemit .....	17
B. Institucionet e zgjedhshme .....	18
C. Frekuenca e zgjedhjeve .....	18
D. Organizimi i njësive zgjedhore .....	18
V. E DREJTA PËR TË ZGJEDHUR DHE PËR T'U ZGJEDHUR .....	20
A. E drejta universale dhe e barabartë për të votuar .....	20
B. Mosdiskriminimi .....	20
C. Shqyrtimi i hollësishëm i çdo kufizimi të së drejtës së votës .....	20

<b>VI. KOMISIONET/ORGANET ZGJEDHORE</b> .....	22
<b>A. Formimi i komisioneve/organeve zgjedhore</b> .....	22
<b>B. Funksionimi i komisioneve/organeve zgjedhore</b> .....	24
<b>VII. REGJISTRIMI I ZGJEDHËSVE DHE LISTAT E ZGJEDHËSVE</b> .....	26
<b>A. Transparenca në proces</b> .....	26
<b>B. Mbrojtja e të dhënave dhe e informacionit personal</b> .....	27
<b>VIII. PARTITË POLITIKE DHE KANDIDATËT</b> .....	29
<b>A. Trajtimi i barabartë përpara ligjit</b> .....	29
<b>B. Vendosja e kandidatëve apo partive në fletën e votimit</b> .....	29
<b>C. Qëndrimi i partive politike dhe kandidatëve gjatë fushatave zgjedhore</b> .....	32
<b>D. Problem i veçantë në lidhje me përfundimin para kohe të mandatit të një kandidati</b> .....	33
<b>IX. TRAJTIMI BARABARTË DHE AKSESI NË MEDIA</b> .....	34
<b>A. Trajtimi i barabartë dhe aksesit</b> .....	34
<b>B. Kufizimet në lirinë e shprehjes gjatë fushatave zgjedhore</b> .....	35
<b>X. FINANCIMI DHE SHPENZIMET PËR FUSHATËN</b> .....	38
<b>A. Fondet publike</b> .....	38
<b>B. Fondet private</b> .....	38
<b>C. Kërkesat për raportim dhe publikim</b> .....	39
<b>XI. VËZHGUESIT</b> .....	41
<b>XII. PROCEDURAT E VOTIMIT</b> .....	43
<b>A. Fshtësia e votës</b> .....	43
<b>B. Procedurat e votimit</b> .....	44
<b>C. Votimi i lëvizshëm</b> .....	44
<b>D. Votimi i forcave ushtarake</b> .....	46
<b>E. Balancimi i kushteve të përshtatshme për zgjedhësit me masat kundër votimit mashtrues</b> .....	46
<b>XIII. RANSPARENCA NË NUMËRIMIN DHE PROTOKOLLIMIN E VOTAVE</b> .....	48
<b>A. Parimi i përgjithshëm</b> .....	48

B. Numërimi i votave .....	48
C. Nxjerrja e rezultateve .....	49
D. Shpallja dhe publikimi i rezultateve .....	50
E. Përcaktimi i datës së saktë për nxjerrjen e rezultateve përfundimtare .....	50
F. Përfundimi në lidhje me sigurinë personale .....	51
<b>XIV. ZBATIMI I TË DREJTAVE ZGJEDHORE .....</b>	<b>53</b>
<b>SHTOJCË</b>	
I. Burimet kryesore për standarte minimale .....	55
A. Kombet e Bashkuara .....	55
B. Këshilli i Evropës .....	56
C. Organizata për Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Evropë .....	56
II. Burime plotësuese .....	58
III. Kodet model .....	59

# I.

## HYRJE

Ky udhëzuesi ka për qëllim të përcaktojë komponentët bazë të një kuadri ligjor që rregullon zgjedhjet, si dhe standartin minimal për secilin komponent, të cilët janë të nevojshëm në mënyrë që kuadri ligjor i një vendi të garantojë zgjedhje demokratike. Synim tjetër i këtij udhëzuesi është t'i ofrojë analistit të një kuadrit ligjor një metodë që do të kontribuojë në uniformitetin, besueshmërinë, njëtrajshmërinë dhe saktësinë e rishikimit të teksteve ligjore që lidhen me zgjedhjet. Ky udhëzues do të orientojë parlamentet kombëtare gjatë hartimit apo ndryshimit të teksteve ligjore që lidhen me zgjedhjet.

Udhëzuesi është përgatitur nga Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) në bashkëpunim me Institutin Ndërkombëtar për Demokraci dhe Asistencë Zgjedhore (International IDEA).<sup>1</sup>

Kapitujt janë paraqitur në mënyrë të tillë që të lehtësojnë rishikimin metodik dhe vlerësimin e kuadrit ligjor. Titulli i çdo kapitulli, duke filluar nga kapitulli i tretë, përcakton çështjet e kuadrit ligjor që trajtohen në kapitullin përkatës. Pas titullit të kapitullit vijon një deklaratë për objektivin e standartit minimal që lidhet me atë komponent të veçantë të kuadrit ligjor. Kjo deklaratë pasohet nga diskutimi i komponentit përkatës të kuadrit ligjor. Kapitulli përfundon me një liste kontrolli të çështjeve që lidhen me komponentin. Analisti mund ta përdorë këtë listë kontrolli për të konfirmuar se kuadri ligjor i ka prekur të gjitha çështjet që lidhen me atë komponent të veçantë të kuadrit ligjor.

---

<sup>1</sup> Nje dokument për diskutim në formën e një projekt-udhëzuesi paraprak u përgatit nga Jessie V. Pilgrim në emër të ODIHR. Projekti ishte objekt diskutimi i ekspertëve të seminarit që u mbajt më 14-15 shtator, 2000, në Stokholm. Projekti u mundësua në sajë të një kontributi bujar nga Zvicra.

## II. BAZAT E STANDARTEVE DHE QËNDRIMI I ANALISTIT

### A. Burimet Themelore të Standarteve Minimale

Burimet themelore të standarteve minimale të paraqitura në këtë udhëzues janë dokumentat ndërkombëtare, si; Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, Karta e Parisit për një Evropë të Re – Takimi i nivelit të lartë i KSB-së (1990) dhe Dokumenti i Mbledhjes së Kopenhagenit të Konferencën mbi Dimensionin Njerëzor të KSBE-së. Teksti që lidhet me këto burime përfshihet në Shtojcë. Përveç kësaj, analisti duhet të marrë parasysht jurisprudencën e organeve mbikqyrëse si Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut dhe Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut.

### B. Burimet Plotësuese

Kur shqyrton kuadrin ligjor të Shteteve pjesëmarrëse të Organizatës për Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Evropë (OSBE), analisti duhet t'u referohet gjithashtu raporteve përfundimtare të misionëve të vëzhgimit të zgjedhjeve të Zyrës për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut ("OSBE/ODIHR") në rastet kur ato janë të disponueshme. Këto raporte mund të gjenden në faqen e Internetit të OSBE/ODIHR në adresën <http://www.osce.org/odihr>

Paragrafi 25 i Kartës të OSBE-së për Sigurimin Evropian të vitit 1999 shprehet: "Ne e pranojmë ndihmën që ODIHR-i mund t'u japë Shteteve pjesëmarrëse në zhvillimin dhe zbatimin e legjisllacionit zgjedhor. Në përputhje me këto angazhime, ne do t'i ftojme vëzhguesit nga Shtete të tjera pjesëmarrëse, nga ODIHR-i, nga Asambleja Parlamentare e OSBE-së dhe nga institucionet e organizatat kompetente që dëshirojnë të vëzhgojnë proceset tona zgjedhore. Ne jemi dakort të ndjekim menjëherë vlerësimin dhe rekomandimet e ODIHR-it për zgjedhjet". Si rrjedhim, çdo rekomandim për hartimin e legjisllacionit zgjedhor në raportet përfundimtare të OSBE/ODIHR-it duhet të jetë pjesë e materialit që analisti duhet të marrë në konsideratë kur të shqyrtoje legjisllacionin e zgjedhjeve në Rajonin e OSBE-së.

Përveç kësaj, analisti duhet të jetë në dijeni të çdo kërkesë që mund të ndikojë në kuadrin ligjor që rregullon zgjedhjet, e cila imponohet një vendi kur ai bëhet palë e një instrumenti të veçantë ndërkombëtar.



Në përfundim, analisti duhet të shohë kodet model që janë përgatitur nga organizata ndërkombëtare qeveritare apo joqeveritare për trajtimin e çështjeve specifike që lidhen me zgjedhjet. Shtojca përfshin disa kode model që janë burime të mira plotësuese.

## **C.** **Qëndrimi i përgjithshëm i analistit**

Analisti duhet të jetë i kujdesshëm për rolin e tij, rol që ka të bëjë me shqyrtimin e kuadrit ligjor për të përcaktuar nëse ai është në përputhje apo jo me standartet minimale. Megjithatë, rishikimi nuk synon të jetë gjykues, por të sugjerojë në mënyrë konstruktive korrigjime, përmirësime dhe praktikë më të mira që duhet të përfshihen në legjisllacion. *Analisti nuk duhet të jetë mbështetës i një sistemi apo praktike të veçantë.*

Një vend ka të drejtë të bëjë zgjedhjen e tij për një sistem të përshtatshëm zgjedhor. Megjithatë, kjo nuk do të thote se çdo sistem apo praktikë zgjedhore që zgjedh një vend është i pranueshëm. E drejta e një vendi për të zgjedhur një sistem zgjedhor nuk është e pakufishme dhe duhet ushtruar në përputhje me standartet minimale. Përveç kësaj, në rast se analisti i kërkohet të komentojë në mënyrë të veçantë nëse një sistem apo praktikë zgjedhore e pranuar nga një vend është e përshtatshme për të, në bazë të faktorëve të veçantë politikë, shoqërorë apo kulturorë, atëherë analisti duhet të bëjë këto komente. Gjithashtu, kur analisti është në dijeni të fakteve të veçanta të një vendi, që e bëjnë një sistem apo praktikë të pranuar zgjedhore të papërshtatshme për atë vend (p.sh. sistemi apo praktika do të pengojë zgjedhjet demokratike për shkak të rrethanave unike të vendit), atëherë analisti duhet të deklarojë këtë papërshtatshmëri. Sidoqoftë, në një rast të tillë, analisti duhet të mbështetet në fakte të provuara.

Një vlerësim serioz kërkon më shumë se sa vetem një shqyrtim të tekstit. Pavarësisht se sa i thelluar është rishikimi, vlerësimi ka pak vlerë në rast se komentet, rekomandimet dhe këshillat nuk janë dhënë në mënyrë të përshtatshme dhe konstruktive. Analisti duhet ta ketë këtë parasysh kur bën komente apo rekomandime.

## **D.** **Respekti**

Çdo koment, rekomandim apo këshillë duhet të karakterizohet nga respekti për subjektin që i jepet këshilla. Ndosht që analisti të jetë nga një vend tjetër, shpesh me njohuri të kufizuara për vendin që po vlerësohet dhe ai presupozohet se jep këshilla për çështje që janë jashtëzakonisht të rëndësishme. Kështu, toni i vlerësimit duhet të pasqyrojë anën delikate të detyrës që po kryen, edhe në rast se kritikë janë të drejtpërdrejta dhe serioze.

## **E. Rëndësia e Madhe e Përkthimeve të Sakta**

Është shumë e rëndësishme që analisti të ketë përkthime të sakta të të gjitha ligjeve të rishikuara. Në disa raste analisti do të punojë me përkthimeve jozyrtare të teksteve. Ai duhet të jetë i ndjeshëm ndaj këtij fakti. Ka disa gabime përkthimi që vihen re më shpejt se disa të tjera. Kur një rekomandim, koment apo kritikë bëhet duke u bazuar në një tekst të përkthyer me gabime, analisti duhet ta deklarojë këtë gjë në vlerësim.

## **F. Përgatitja**

Mungesa e respektit të mjaftueshëm gjatë vlerësimit, është çdo gjë e përfshirë në këtë vlerësim që sugjeron se analisti nuk ka i ka kushtuar atij vëmendjen e duhur. Analisti duhet të kryejë detyrat që i takojnë. Për shembull, është diçka joprofesionale nëqoftëse një analist rekomandon një ndryshim në ligjin për zgjedhjet, në një kohe kur ai nuk arrin të dallojë se një gjë e tillë bie në kundërshtim me kushtetutën. Sigurisht që kjo presupozon se vete kushtetuta nuk bie ndesh me standartet minimale. Vlerësimi duhet të jetë korrekt si me ligjin e brendshëm ashtu dhe me standartet minimale.

## **G. Klasifikimi i Rekomandimeve Sipas Përparësisë**

Analisti duhet të bëjë dallim midis asaj që është e dëshirueshme në një botë ideale and asaj që kërkohet sipas standarteve minimale. Ka të ngjarë që jo të gjitha rekomandimet të merren parasysh. Për rrjedhojë, është themelore që rekomandimet të renditen sipas përparësisë. Përveç kësaj, në disa rekomandime duhet të përdoren terma më të kujdesshëm se sa në disa të tjera (“do të ishte me vend...” krahasuar me “është themelore që...” apo “rekomandohet me forcë që...”). Rekomandimet duhet të përmbajnë terma të zgjedhur me kujdes dhe duhen renditur sipas përparësisë.

## **H. Theksoni Ligjshmërinë ku të Jetë e Mundur**

Analisti duhet të theksojë se zbatimi i rekomandimeve do të rrisë besueshmërinë dhe besimin e publikut tek zgjedhjet. Kjo është diçka që dëshiron ta arrijë çdo qeveri. Një gjë e tillë mund të jetë veçanërisht e përshtatshme kur rekomandohen masa për të rritur transparencën.

## I. Shpjegoni Arsyen e Rekomandimit

Eshtë e rëndësishme të shpjegohet përse bëhet një rekomandim i caktuar. Disa rekomandime bëhen me qëllim që të rrisin përputhshmërinë me standardin minimal, me një angazhim të caktuar ndërkombëtar, apo me një të drejte njerëzore të caktuar. Të tjera rekomandime bëhen thjesht për ta bërë legjislacionin më koherent apo të efektshëm, siç janë rekomandimet që lidhen me kontradikta apo boshllëqe të veçanta në ligjet nën shqyrtim. Analisti duhet të shpjegojë arsyen përse e bën rekomandimin.

## J. Detaje më të Hollësishme

Analisti duhet të jetë i përgatitur të pranojë se jo çdo gjë duhet të rregullohet nga aktet ligjore. Do të ishte me vend që disa detaje më të hollësishme të procedurave zgjedhore t'u kalohen akteve nënligjore të miratuara nga organet qeveritare, përfshi këtu edhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Megjithatë, çështjet bazë duhen trajtuar nga aktet ligjore. Analisti duhet të dijë cilat çështje duhen mbuluar në mënyrë të veçantë nga ligji dhe cilat mund të qartësohen nga rregulloret administrative.

### III.

## STRUKTURA E KUADRIT LIGJOR

**OBJEKTIVI:** Kuadri ligjor duhet të strukturohet në mënyrë të tillë që publiku të ketë akses lehtësisht, të jetë transparent dhe të trajtojë të gjithë komponentet e një sistemi zgjedhor të nevojshëm për të siguruar zgjedhje demokratike.

Kuadri ligjor duhet strukturuar në mënyrë të tillë që të përputhet me objektivin e mësipërm. Autoritetet e vendit duhet të krijojnë një strukturë legjislacioni sipas traditave ligjore të vendit dhe analisti duhet të jetë i hapur për të pranuar alternativa të ndryshme. Ajo që ka rëndësi është se analisti duhet të jetë i ndërgjegjshëm për metodat e ndryshme strukturore dhe të marrë në shqyrtim gjithë materialin legjislativ që mund të ndikojë në zhvillimin e zgjedhjeve. Megjithatë, struktura e legjislacioniit zgjedhor ka disa pasoja për të cilat analisti duhet të jetë i vetëdijshëm dhe duhet të ofrojë këshilla kur ai e sheh të nevojshme. Kështu analisti duhet të jetë i vëmendshëm ndaj parimeve të mëposhtme.

#### A.

### Përdorimi dhe Vlera e Ligjit të Shkruar

Megjithëse një qeveri ka fleksibilitet në ndërtimin e strukturës së kuadrit ligjor, është e nevojshme që një ligj i shkruar të jetë instrument rregullues në fushën e zgjedhjeve, sesa zakoni apo politikat administrative. Ligji i shkruar, si mjet zgjedhjeje, ofron përfitimet e barazisë, sigurisë, aksesit dhe transparencës dhe bën që çështja t'i nënshtrohet interpretimit dhe rishikimit juridik dhe të jetë e hapur për referim nga qytetarët.

#### B.

### Dispozitat Kushtetuese

Përfshirja në kushtetute e parimeve bazë të sistemit të zgjedhjeve krijon një mburojë ndaj ndryshimeve të shpeshta. Ndryshimet kushtetuese shpesh i nënshtrohen votimit me shumicë të cilësuar apo proceseve të tjera të vështira. Kështu, është praktikë e rekomandueshme përfshirja në kushtetutën e një vendi e garancive themelore që mbrojnë të drejtën e votës. Kjo do të përfshinte dispozitat që rregullojnë çështjet më themelore të sistemit zgjedhor, siç është e drejta për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur, institucionet që u nënshtrohen zgjedhjeve demokratike dhe mandatet e kandidatëve të zgjedhur.

Meqënëse amendamentet e çdo kushtetute u nëshetrohen normalisht procedurave të ndërlkuara dhe që kërkojnë kohë, nuk preferohet që dispozitat kushtetuese të shkojnë më tej se sa përshkrimi i vetë çështjeve më themelore të sistemit zgjedhor dhe garantimi i të drejtave themelore. Me qëllim që të lejohet fleksibiliteti i nevojshëm, administrimi i zgjedhjeve dhe çështje të tjera proceduriale duhet të rregullohen nga legjislacioni i nxjerrë nga parlamenti dhe rregullat administrative të nxjerra nga organe të autorizuar të administratës zgjedhore.

### **C.**

## **Legjislacioni i Përgjithshëm i Zgjedhjeve Kundrejt Atij të Posaçëm**

Legjislacioni kombëtar i zgjedhjeve mund të ndahet në dy kategori:

- Legjislacioni i përgjithshëm i zgjedhjeve që i përket të gjitha llojeve të zgjedhjeve

Përcakton një kuadër ligjor i cili rregullon të gjitha zgjedhjet, përfshi edhe zgjedhjen e degëve ekzekutive dhe legjislative, në nivel kombëtar dhe lokal.

- Legjislacioni i posaçëm i zgjedhjeve që i referohet një organi të caktuar të qeverisë, apo referendumeve

Vendos dispozita ligjore të veçanta që rregullojnë zgjedhjet e një organi të veçantë të qeverisë me dispozita që devijojnë nga kuadri i përgjithshëm ligjor për zgjedhjet.

Vende të ndryshme e kanë trajtuar në mënyra të ndryshme ndarjen midis legjislacionit të përgjithshëm dhe atij specifik. Një vend mund të miratojë një ligj të veçantë mbi "parimet bazë" të zgjedhjeve, duke përcaktuar dispozita që janë të zbatueshme për të gjitha zgjedhjet. Përveç kësaj, vendi duhet të miratojë ligje të posaçme për zgjedhjen e secilit organ shtetëror ku do të përfshihen të gjitha dispozitat e veçanta për atë zgjedhje të caktuar. Në ndryshim me këtë rast, një vend tjetër mund ta përfshijë gjithë legjislacionin zgjedhor në një ligj të vetëm, me kapituj të veçantë që pëmbajnë dispozita për zgjedhje të ndryshme.

Megjithëse secila nga metodat e lartpërmendura është e pranueshme, do të shumë i dëshirueshëm dhe i rekomandueshëm një ligj zgjedhor që të rregullonte të

gjitha llojet e zgjedhjet. Legjislacioni i përgjithshëm për zgjedhjet që rregullon të gjitha llojet e zgjedhjeve është i nevojshëm pasi siguron njëtrajtshtëri në administrimin dhe praktikën e zgjedhjeve, në funksion të zbatimit të unifikuar të ligjit për të gjitha llojet e zgjedhjeve. Kjo mënyrë e bën gjithashtu më të thjeshtë procesin e hartimit të amendamenteve në legjislacion, në rastet ku ato janë të nevojshme. Sidoqoftë, duhet kuptuar se në disa raste, veçanërisht në sistemet e federuara, një metodë e tillë mund të mos jetë e realizueshme.

Pavarësisht se cila nga metodat e lartpërmendura është adoptuar nga një vend, kur vlerësojmë legjislacionin zgjedhor duhen respektuar disa parime të caktuara:

- Legjislacioni zgjedhor duhet të shprehet me gjuhë objektive. Interpretimi i legjislacionit të zgjedhjeve nuk duhet t'i nënshtrohet opinionit subjektiv.
- Legjislacioni zgjedhor duhet të shmangë dispozitat konfliktuese midis ligjeve që rregullojnë zgjedhjet kombëtare dhe ligjeve që rregullojnë zgjedhjet lokale. Dispozitat që rregullojnë administrimin e zgjedhjeve kombëtare duhet të harmonizohen me dispozitat që rregullojnë zgjedhjet lokale.
- Marrëdhëniet midis autoriteteve kombëtare dhe atyre lokale, si dhe midis organeve të administratës zgjedhore dhe organeve të tjera qeveritare, duhet të deklarohen e përcaktohen qartë. Autoriteti i organeve të administratës zgjedhore duhet të deklarohet dhe përcaktohet qartë për të shmangur konfliktin apo mbivendosjen me pushtetin e mbajtur nga organet e tjera qeveritare.
- Legjislacioni zgjedhor duhet të miratohet kohë përpara zgjedhjeve në mënyrë që pjesëmarrësit politikë dhe zgjedhësit të kenë kohë të mjaftueshme për t'u informuar rreth rregullave të proceseve zgjedhore. Legjislacioni zgjedhor i miratuar "minutën e fundit" minon legjitimitetin e legjislacionit dhe pengon pjesëmarrësit politike dhe zgjedhësit që të informohen në kohën e duhur për rregullat e proceseve zgjedhore.
- Legjislacioni zgjedhor duhet të miratohet në përputhje me dispozitat ligjore përkatëse që rregullojnë nxjerrjen e ligjeve nga parlamenti. Legjislacioni zgjedhor që nuk miratohet në përputhje me dispozitat ligjore mund të verë në diskutim ligjshmërinë dhe rrezikon të anulohet nga gjykatat.
- Legjislacioni zgjedhor duhet të publikohet dhe t'i vihet në dispozicion publikut.

## **D. Legjislacioni Zgjedhor kundrejt Legjislacioneve të Llojeve të Tjera**

Ligji zgjedhor as nuk mund e as nuk duhet të përmbajë të gjitha rregullat që kanë të bëjnë me procesin e zgjedhjeve. Procesi zgjedhor kërkon angazhimin e institucioneve dhe procedura që bazohen në pjesë të tjera të sistemit ligjor kombëtar. Është e rëndësishme që analisti të jetë i vetëdijshëm për ekzistencën e legjislacioneve të llojeve të tjera që kanë lidhje me zgjedhjet dhe t'i përfshijë ato në procesin e rishikimit. Rëndësi të veçantë ka legjislacioni kombëtar që rregullon median, rregjistrimin e partive politike, shtetësinë dhe dispozitat penale që lidhen me shkeljet e ligjit për zgjedhjet. Analisti duhet të identifikojë dhe shqyrtojë të gjitha dispozitat ligjore që ndikojnë në procesin e zgjedhjeve.

## **E. Legjislacioni Zgjedhor kundrejt Udhëzimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve**

Në një sistem demokratik, i gjithë kuadri ligjor për zgjedhjet miratohet nga një parlament kombëtar i zgjedhur në mënyrë demokratike. Për të mbrojtur vlerat demokratike, rregullat për zgjedhjet nuk duhet të miratohen me dekret të nxjerrë nga dega ekzekutive e qeverisë. Megjithatë, ka limite të numrit e rregullave procedurale që mund të përfshihen në një ligj. Kështu, pjesa më e madhe e ligjeve zgjedhore lejojnë organin më të lartë administrativ zgjedhor, zakonisht Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) të nxjerrë udhëzime për të qartësuar më tej çështjet që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor. Megjithatë, legjislacioni zgjedhor duhet të kërkojë që udhëzime të tilla të bazohen drejtpërdrejt në dispozita të legjislacionit zgjedhor.

Roli i KQZ-së në lidhje me nxjerrjen e udhëzimeve të hollësishme duhet të kuptohet qartë. Roli i saj nuk është të veprojë si një ligjvënës zëvendësues, por t'u përgjigjet nevojave për qartësim nëpërmjet interpretimit dhe plotësimit të rregullave për zgjedhjet. Legjislacioni zgjedhor duhet të krijojë një ekuilibër që i lejon KQZ-së lirshmërinë e nevojshme për t'ju përgjigjur nevojave të dukshme, por gjithmonë duke mos cënuar parimin e kontrollit legjislativ ndaj legjislacionit zgjedhor.

Disa parime të caktuara duhet të respektohen në rastet kur KQZ-ja autorizohet të nxjerrë udhëzime. Këto parime përfshijnë:

- Të drejtat themelore të mirëfillta, të tilla si votimi i fshehtë, nuk mund të shfuqizohen apo pakësohen me një udhëzim të KQZ-së.
- Autoriteti i KQZ duhet të deklarohet e përcaktohet qartë në legjislacionin zgjedhor. Legjislacioni zgjedhor duhet të shprehë e përcaktojë qartë fushën e veprimit dhe shtrirjen e autoritetit të KQZ-së për të nxjerrë udhëzime.
- Legjislacioni zgjedhor duhet të shprehë qartë se udhëzimet e KQZ-së nuk duhet të jenë në kundërshtim apo papajtueshmëri me legjislacionin zgjedhor.
- Legjislacioni zgjedhor duhet të sigurojë një proces të tillë ku pjesëmarrësit politike dhe zgjedhësit të kenë mundësi të paraqesin ankime dhe apelime që burojnë nga miratimi dhe zbatimi i udhëzimeve të KQZ-së. Ky proces duhet të lejojë gjithashtu ankime dhe apelime që vijnë si rezultat i shkeljes së legjislacionit zgjedhor nga ana e KQZ-së.
- Legjislacioni zgjedhor duhet të përcaktojë qartë hierarkinë e normave ligjore që rregullojnë zgjedhjet. Duhet shprehur qarte se dispozitat kushtetuese dhe legjislative kanë përparësi ndaj udhëzimeve të KQZ-së.
- Autoriteti i KQZ-së dhe procesi që ajo duhet të ndjekë për të nxjerrë udhëzime në situata të jashtëzakonshme ose në Ditën e Zgjedhjeve, duhet të shprehet e përcaktohet qartë në legjislacionin zgjedhor.

## F. Shtrirja e Analizës

Analisti duhet të rishikojë të gjitha dispozitat ligjore që zbatohen në një vend, të cilat mund të kenë lidhje me çështjet që lindin nga standartet minimale të përcaktuara në këtë udhëzues. Analisti asnjëherë nuk duhet të supozojë se një çështje nuk është trajtuar në kuadrin ligjor, për shkak se ajo nuk është trajtuar në kodin zgjedhor. Analisti duhet të rishikojë të gjitha dispozitat ligjore për këtë çështje, përfshirë kushtetuten e vendit dhe legjislacione të tjera që kanë ndikim në proceset zgjedhore. Po të jetë e mundur dhe e përshtatshme, udhëzimet dhe rregulloret e KQZ duhet të përfshihen në rishikim.



### **LISTË KONTROLLI PËR STRUKTURËN E KUADRIT LIGJOR**

- ✓ A është kuadri ligjor objektiv, i qartë, transparent dhe i përdorshëm nga publiku?
- ✓ A janë të drejta themelore e votës e siguruara e mbrojtura me Kushtetutë?
- ✓ A janë rishikuar të gjitha ligjet përkatëse, përfshirë Kushtetutën, legjislationet e përgjithshme dhe specifike të zgjedhjeve, shtetësinë, partitë politike, median dhe legjislationin për informimin publik, dispozitat penale që lidhen me shkeljet e ligjit zgjedhor dhe me Udhëzimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve?

## IV. SISTEMI ZGJEDHOR

**OBJEKTIVI:** Zgjedhja e sistemit zgjedhor duhet të sigurojë standartet minimale për zgjedhje demokratike, në lidhje me institucionet që, shpeshësinë e zgjedhjeve dhe organizimin e njërive zgjedhore.

### A. Zgjedhja e Sistemit

Zgjedhja që bën një vend për sistemin e tij zgjedhor duhet respektuar në rast se ai plotëson standartin minimal për zgjedhje demokratike. Materiale referimi mbi sisteme të ndryshme zgjedhore, të cilat analisti mund t'i konsultojë, përfshihen në seksionin e Burimeve Plotësuese të Shtojcës.

Megjithatë, në një masë të mundshme, analisti duhet të jetë i vëmendshëm ndaj pasojave që mund të vijnë nga zbatimi i një sistemi të veçantë zgjedhor brenda kuadrit të një vendi të caktuar. Edhe kur partia qeverisëse mund të mos e ketë bërë zgjedhjen e sistemit zgjedhor, një gjë e tillë përsëri mund t'i japë kësaj partie një avantazh të padrejtë në zgjedhje. Kështu, në rast se ka ndonjë dyshim në lidhje me këtë pikë, i dobishëm mund të jetë shqyrtimi i rezultateve të zgjedhjeve të mëparshme, për të parë sa shumë ka ndryshuar pushteti politik i partisë sunduese pas ndryshimeve në kuadrin ligjor. Në si pse e sheh me vend, analisti mund të shqyrtojë edhe faktin se sa kohë ka qëndruar në pushtet partia qeverisëse dhe shkallën e angazhimit të kësaj partie në paraqitjen apo kryerjen e ndryshimeve në sistemin e caktuar zgjedhor. Kjo është veçanërisht e vërtetë në një sistem përfaqësimi proporcional, ku ligji përcakton një përqindje të votave si prag të ligjshëm për të siguruar një vend në parlament.

Në kuadër të shqyrtimit të legjislacionit, analisti duhet të marrë gjithashtu në konsideratë edhe faktin nëse një vend ka ndarje të thella politike, fetare apo etnike dhe nëse pakicat janë përfaqësuar si duhet në sistemin politik. Në qoftë se vendi ka ndonjë problem të veçantë, i cili mund t'i atribuohet drejtpërdrejt zgjedhjes së sistemit zgjedhor ose që mund të korrigjohet me zbatimin e një sistemi të ndryshëm zgjedhor, atëherë analisti duhet të komentojë avantazhet dhe disavantazhet e sistemeve të ndryshme zgjedhore dhe të bëjë rekomandimet përkatëse. Materialet e referimit mbi sisteme të ndryshëm zgjedhorë që synojnë të trajtojnë probleme të veçanta, siç p.sh. një shoqëri të ndarë nga një konflikt etnik, janë përfshirë në Shtojcë.

## B. Institucionet e Zgjedhshme

Nje ilustrim për standartin minimal për institucionet që duhet të krijohen nga zgjedhjet demokratike është standarti i shprehur në Paragrafin 7.2 të Dokumentit të OSBE-së, Kopenhagen 1990, i cili kërkon që “të gjitha vendet në të paktën njërën nga dhomat e legjislativit kombëtar të ndahen lirisht me një votim demokratik”. Megjithatë, analisti duhet të jetë në dijeni se një vendi, i cili kërkon të pranohet në një organizatë të caktuar ndërkombëtare, ose që ka nënshkruar një instrument të caktuar ndërkombëtar, mund t’i kërkohej të organizojë zgjedhje demokratike për institucione të tjera.

## C. Frekuenca e Zgjedhjeve

Ilustrim për standartin minimal që rregullon intervalet e zgjedhjeve është standarti i shprehur në Paragrafin 7.1 të Dokumentit të OSBE-së, Kopenhageni 1990, sipas të cilit zgjedhjet demokratike duhet të mbahen në intervale kohore të arsyeshme, të parashikuara nga ligji. Kjo kërkon që zgjedhjet të zhvillohen në përputhje me kuadrin ligjor ekzistues dhe të planifikohen brenda parametrave kohorë të përcaktuar nga ky kuadër.

## D. Organizimi i Njërive Zgjedhore

Kuadri ligjor duhet të zgjidhë çështjen se si do të organizohen njësitë zgjedhore (zonat zgjedhore). Kuadri ligjor që rregullon përcaktimin e kufijve të njërive zgjedhore duhet të shprehë (1) frekuenca, (2) kriteret, (3) shkallën e pjesëmarrjes së publikut, (4) rolet përkatës të degëve legjislative, gjyqësore dhe ekzekutive të pushtetit dhe (5) subjektin që ka autoritetin vendimtar për të zgjedhur planin përfundimtar për njësitë zgjedhore. Ligji duhet të përcaktojë gjithashtu se në çfarë kushtesh një njësi zgjedhore mund të devijojë nga kriteret e përcaktuara. Njësitë zgjedhore duhet të ndahen në mënyrë të tillë që të ruhet barazia midis zgjedhësve. Kështu, ligji duhet të kërkojë që njësitë zgjedhore të përcaktohen në mënyrë të tillë që secila prej tyre të ketë afërsisht të njëjtin numër zgjedhësish. Mënyra se si përcaktohen njësitë zgjedhore duhet të bazohet në parimin e barazisë së votës, që është gur themeli për zgjedhjet demokratike. Sidoqoftë, kjo nuk përjashton marrjen në konsideratë të lehtësive dhe kushteve të përshtatshme për zgjedhësit, duke përfshirë këtu përvijimin e kufijve administrative të mëparshëm.

Në mënyrë ideale, kuadri ligjor duhet të përcaktojë se personat apo institucioni që cakton kufirin e njërive zgjedhore duhet të jenë asnjëherë, të pavarur dhe të paanshëm. Kuadri ligjor duhet të sigurojë kufijtë maksimalë të kontributit dhe pjesëmarrjes publike në procesin e ndarjes së njërive zgjedhore.

### **LISTË KONTROLLI I ANALISTIT PËR SISTEMIN ZGJEDHOR**

- ✓ A siguron zgjedhja e sistemit zgjedhor standarte minimale për zgjedhje demokratike?
- ✓ A i nënshtohen të gjitha vendet e të paktën njëres nga dhomat e legjislatures kombëtare zgjedhjeve demokratike?
- ✓ A janë mbajtur zgjedhjet demokratike në intervale të arsyeshëm kohorë?
- ✓ A trajton kuadri ligjor mënyrën se si janë organizuar njësitë zgjedhore?

## V. E DREJTA PËR TË ZGJEDHUR DHE PËR T'U ZGJEDHUR

**OBJEKTIVI:** Kuadri ligjor duhet të sigurojë garantimin e të drejtës universale dhe të barabartë për të votuar të të gjithë qytetarëve me moshë madhore.

### A. E drejta Universale dhe e Barabartë për të Votuar

Nje standart minimal që duhet të plotësojë kuadri ligjor është garantimi i të drejtës universale dhe të barabartë për të votuar për çdo shtetas madhor. E drejta për të zgjedhur duhet t'i garantohet çdo shtetasi që arrin moshën madhore. E drejta për t'u zgjedhur mund të kërkojë një moshë më të madhe se sa mosha madhore. Megjithatë, e drejta për t'u zgjedhur duhet t'i garantohet çdo shtetasi që arrin moshën e përcaktuar me ligj.

### B. Mosdiskriminimi

Kuadri ligjor duhet të sigurojë që çdo shtetas mbi një moshë të caktuar ka të drejtën e votës dhe çdo njeri që ka të drejtën e votës lejohet ta ushtrojë atë pa u diskriminuar, mbi bazën e barazisë përpara ligjit. Një ilustrim i këtij parimi është Paragrafi 7.3 i Dokumentit të OSBE-së, Kopenhagen 1990, i cili garanton “të drejtën e barabartë për të votuar”. Zbatimi i këtij parimi kërkon që një person, i cili ka të drejtën e votës, të lejohet të ushtrojë këtë të drejtë pa asnjë dallim race, ngjyre, seksi, gjuhe, feje, bindje politike apo ndonjë bindje tjetër, origjine kombëtare apo shoqërore, anëtarësie në një minoritet kombëtar, pasurie, lindjeje apo status tjetër. Analisti duhet të shqyrtojë dhe vlerësojë me vëmendje çdo dispozitë që mund të diskriminojë një shtetas në ushtrimin e të drejtës së tij për të votuar.

### C. Shqyrtimi i Hollësishëm i Çdo Kufizimi të së Drejtës së Votës

Kuadri ligjor duhet të shprehë qartë se në cilat kushte dhe në çfarë mënyre apo mase kufizohet të drejta për të votuar e një personi. Çdo kufizim apo pengesë e të

drejtës për të votuar apo për t'u votuar duhet të shqyrtohet me imtësi dhe çdo kufizim apo pengese duhet të justifikohen qartë kur ato bëhen në kushte të jashtëzakonshme. Analistit i kërkohet të bëjë një shqyrtim të hollësishëm dhe të kujdesshëm, pasi e drejta e votës është një e drejtë themelore e njeriut.

### **LISTË KONTROLLI E ANALISTIT MBI TË DREJTËN PËR TË ZGJEDHUR DHE PËR T'U ZGJEDHUR**

- ✓ A u është garantuar të gjithë qytetarëve në moshë madhore e drejta e përgjithshme dhe e barabartë për të votuar?
- ✓ A siguron kuadri ligjor se e drejta e votës ushtrohen në mënyrë jodiskriminuese bazuar në trajtimin e barabartë përpara ligjit?
- ✓ A ka ndonjë kufizim apo pengesë lidhur me të drejtën për të votuar dhe në rast se po, a janë ato të justifikuara si rezultat i krijimit të kushteve të jashtëzakonshme?

## VI. KOMISIONET/ORGANET ZGJEDHORE

**OBJEKTIVI:** Kuadri ligjor duhet të kërkojë që komisionet/organet zgjedhore të krijohen dhe të funksionojnë në mënyrë të tillë që të sigurojnë administrimin e pavarur dhe të paanshëm të zgjedhjeve.

### A. Formimi i Komisioneve/Organeve Zgjedhore

Administrimi i zgjedhjeve demokratike kërkon që komisionet/organet zgjedhore të jenë të pavarur dhe të paanshme. Kjo është një fushë shumë delikate pasi makineria e administratës zgjedhore merr dhe zbaton vendime të rëndësishme që mund të influencojnë në rezultatin e zgjedhjeve. Analisti duhet të jetë i vetëdijshëm për kushtet politike të një vendi të caktuar, kur ai vlerëson kuadrin ligjor që rregullon komisionet/organet zgjedhore të atij vendi.

Një formulë përbërjeje e komisioneve zgjedhore, bazuar në përfaqësimin partiak mund të jetë një zgjidhje e përshtatshme, por analisti duhet të shqyrtojë veçanërisht pasojat aktuale të kësaj strukture. Pikëpamjet e çdo force opozitare, nëse ka të tilla, mund të ndihmojnë në mënyrë të dukshme në identifikimin e pasojave praktike dhe të dobësive të një strukture të caktuar. Në rast se kuadri ligjor miraton një formulë me përfaqësim partiak, atëherë ai duhet të trajtojë kur dhe si duhet të ketë ndryshime në anëtarësinë e komisionit në varësi të ndryshimeve në forcën dhe anëtarësinë e partive, veçanërisht kur ka parti të reja.

Struktura administrative e përcaktuar në kuadrin ligjor duhet të përfshijë një komision qendror apo shtetëror zgjedhor me autoritet dhe përgjegjësi ndaj komisioneve zgjedhore vartëse. Për çdo njësi zgjedhore (zonë zgjedhore), në të cilën zgjidhet një anëtar i pushtetit legjislativ, duhet të ketë një komision zgjedhor vartës. Nevoja për krijimin e komisioneve ndërmjetëse zgjedhore varet nga sistemi zgjedhor dhe faktorët gjeografike dhe demografikë të vendit. Megjithatë, analisti duhet të jetë i vëmendshëm ndaj komisioneve zgjedhore që duken të panevojshëm. Niveli më i ulët i struktures së komisionit zgjedhor duhet të jetë niveli i qendrës së votimit atje ku bëhet votimi. Është e shumë rëndësishme që kuadri ligjor të përcaktojë lidhjen midis komisionit qendror të zgjedhjeve dhe komisioneve më të ulëta zgjedhore si dhe lidhjen midis të gjitha komisioneve zgjedhore dhe autoriteteve të pushtetit ekzekutiv.

Autoriteti dhe përgjegjësia e secilit nivel të komisioneve zgjedhore duhet të përcaktohet qartë në kuadrin ligjor. Ligji duhet të përmbajë dispozita të qarta mbi mënyrën sesi komisionet duhet të kryejnë funksionet e tyre. Ai duhet të shprehë se si, kur dhe çfarë lloj njoftimi duhet t'i bëhet publikut për mbledhjet e komisionit. Ligji duhet të shprehë kërkesat për kuorumin e kërkuar, rregullat e votimit për marrjen e vendimeve, mënyrat e publikimit të vendimeve dhe të përmbajë dispozita të qarta për transparencë, në mënyrë që puna e komisionit të vëzhgohet dhe monitorohet.

Atje ku është e mundur, profesionistët që kanë njohuri mbi kuadrin zgjedhor të një vendi duhet të jenë personat që duhet caktuar për të administruar zgjedhjet në vend. Kështu, një dispozitë e zakonshme që gjendet në shumë kuadre ligjorë kërkon që anëtarët e komisioneve, të çdo niveli, të kenë njohuri apo të jenë trajnuar në fushën e ligjeve. Në dukje, një dispozitë e tillë është e pranueshme, megjithëse ajo mund të jetë shumë kufizuese për komisionet e niveleve të ulta dhe për komisionet e qendrave të votimit. Megjithatë, për aq sa është e mundur, analisti duhet të vlerësojë dispozita të tilla brenda kontekstit të një vendi të caktuar. A është rezultat i kësaj dispozite fakti që personat e vetëm që plotësojnë kushtet për të qenë anëtarë komisioni janë ata që anojnë në favor të një partie të caktuar? Ky mund të jetë rasti kur ligji kërkon që anëtarët e komisionit të jenë gjykatës dhe partia në pushtet i emëron ata. Nëse është e mundur, analisti duhet të bëjë përpjekje për të përcaktuar pasojat praktike të dispozitave ligjore që rregullojnë kualifikimet e anëtarëve të komisioneve zgjedhore.

Komisionet shtetërore apo qëndrore të zgjedhjeve duhet të jenë organe që funksionojnë në mënyrë dhe jo për një periudhë kohore të kufizuar përpara zgjedhjeve. Kjo do të thotë që komisionit qendror të zgjedhjeve duhet t'i kerkohet me ligj të punojë në mënyrë të vazhdueshme për të përmirësuar listat e zgjedhësve dhe për të ndërmarrë veprime të tjera për të përmirësuar procesin zgjedhor. Megjithatë, është normale që komisione/organe më të ulëta zgjedhore, siç janë komisionet e qendrave të votimit, të jenë organe të përkohshme që krijohen para zhvillimit të zgjedhjeve. Kuadri ligjor duhet të kërkojë që organe të tilla të krijohen në kohën e duhur para organizimit të zgjedhjeve dhe të financohen në mënyrë të mjaftueshme. Kuadri ligjor duhet të parashikojë gjithashtu fonde të mjaftueshme për veprimtarinë në vazhdim të komisionit qendror të zgjedhjeve.

Kuadri ligjor duhet të sigurojë që metoda për zgjedhjen e anëtarëve të komisionit zgjedhor të jetë asnjansë. Përveç kësaj, sugjerohet që mandatet e anëtarëve të rinovohen pjesë-pjesë për të siguruar vazhdimësinë e punës në komisionet pasardhëse. Metoda për zgjedhjen e anëtarëve të komisionit duhet të jetë e hapur dhe transparente. Kuadri ligjor duhet të përcaktojë gjithashtu shkaqet dhe procedurat për shkarkimin e një anëtari. Ligji duhet të përmbajë dispozita të hartuara me qëllim inkurajimin e pavaresisë



dhe paanshmërisë së anëtareve, duke përfshirë dispozita që mbrojnë anëtarët nga shkarkimi arbitrar, si dhe dhënien e imunitetit në pëmbushjen e detyrave ligjore. Ligji duhet të përcaktojë gjithashtu të drejtat e secilit anëtar të komisionit, përfshirë të drejtën për të marrë njoftimin përkatës dhe në kohën e duhur për mbledhjet, të drejtën e aksesit në të gjitha dokumentat e komisionit dhe të drejtën për të marrë pjesë në të gjitha mbledhjet e komisionit.

Analisti duhet të bindet që kuadri ligjor siguron që një komision zgjedhor do të jetë një organ i pavarur që pëmbush detyrat e tij në mënyrë të paanshme. Kuadri ligjor duhet të përcaktojë qartë detyrat e një komisioni zgjedhor, që janë:

- të sigurojë që zyrtarët dhe personat e ngarkuar me administrimin e zgjedhjeve të jenë të përgatitur dhe të veprojnë në mënyrë të pavarur dhe të paanshme;
- të sigurojë se janë përcaktuar procedurat koherente të votimit dhe u janë bërë të njohura publikut që do të marrë pjesë në zgjedhje;
- të sigurojë se zgjedhësit janë informuar dhe edukuar në lidhje me proceset zgjedhore, partitë politike dhe kandidatët;
- të sigurojë regjistrimin e zgjedhësve dhe përditësimin e listave të zgjedhësve;
- të sigurojë integritetin e votës duke marrë masat e përshtatshme për të mos lejuar votimin e paligjshëm dhe mashtues;
- të sigurojë integritetin e procesit të numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultatit;
- të vërtetojë rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve.

## **B.** **Funksionimi i Komisioneve/Organeve Zgjedhore**

Pavarësisht nga mënyra e krijimit dhe shkalla e mbështetjes partiake, organet e administratës zgjedhore duhet të funksionojnë në mënyrë të pavarur, kolegjiale dhe të paanshme. Menjëherë sapo formohet, organi i administratës zgjedhore duhet t'u shërbejë interesave të të gjithë qytetarëve dhe pjesëmarrësve në zgjedhje. Asnjë organ i administratës zgjedhore nuk duhet të veprojë në mënyrë të njëanshme apo të shfaqë mbështetje për njërin palë apo tjetrën në pëmbushjen e detyrave të tij.

Kuadri ligjor duhet të sigurojë gjithashtu mekanizma kur një zgjedhës, një vëzhgues, parti politike apo kandidat i pakënaqur kërkon ndryshimin e vendimit përfundimtar të një komisioni apo organi zgjedhor. Të tilla mund të jetë apelimi pranë një komisioni/organi më të lartë zgjedhor, ose apelim pranë një gjykate, kur vendimi është marrë nga komisioni/organi më i lartë zgjedhor. E rëndësishme është që kuadri ligjor të sigurojë mundësinë për ndryshim e një vendimi të marrë nga një komision/organ zgjedhor.

### **LISTË KONTROLLI PËR KOMISIONET/ORGANET ZGJEDHORE**

- ✓ A kërkon kuadri ligjor që komisionet e zgjedhjeve të krijohen në mënyrë të pavarur dhe të paanshme?
- ✓ A kërkon kuadri ligjor që komisionet e zgjedhjeve të funksionojnë në mënyrë të pavarur dhe të paanshme?
- ✓ A kërkon kuadri ligjor transparencë në krijimin dhe funksionimin e komisioneve zgjedhore dhe a parashikon ai që vëzhguesit të monitorojnë punën e tyre?
- ✓ A përcaktohet qartë në kuadrin ligjor autoriteti dhe përgjegjësia e secilit komision zgjedhor dhe marrëdhëniet e tij me organe të tjera qeveritare dhe autoritete ekzekutive?
- ✓ A parashikon kuadri ligjor mundësi të mjaftueshme për të kërkuar ndryshimin e një vendimi të marrë nga një komisioni zgjedhor?
- ✓ A i mbron kuadri ligjor anëtarët e komisionit zgjedhor nga shkarkimi arbitrar?

## VII.

# REGJISTRIMI I ZGJEDHËSVE DHE LISTAT E ZGJEDHËSVE

**OBJEKTIVI:** Kuadri ligjor duhet të kërkojë që listat e zgjedhësve të administrohen në mënyrë transparente e të saktë, të mbrojnë të drejtën për t'u regjistruar të shtetasve që kanë mbushur moshën e kërkuar nga ligji dhe të mos lejojnë regjistrimin e paligjshëm apo në rrugë të pandershme të votuesve.

### A.

## Transparenca në Proces

E drejta për të votuar zhvlerësohet në qoftë se kuadri ligjor vështirëson regjistrimin e një personi për të votuar. E drejta për të votuar ka gjithashtu një vlerë më të vogël në rast se kuadri ligjor nuk arrin të sigurojë saktësi në listat e zgjedhësve ose krijon lehtësi për një votim mashtrues apo të dyfishtë. Kështu, standarti minimal për regjistrimin e zgjedhësve dhe ruajtjen e listave është ekzistenca e një transparence të plotë gjatë këtij procesi. Transparenca e plotë në proces duhet të garantojë që regjistrimi të jetë i thjeshtë për një person që ka të drejtën e votës dhe në të njëjtën kohë të sigurojë saktësi për të parandaluar votimin mashtrues. Analisti duhet të rishikojë me kujdes kuadrin ligjor dhe të bindet se ky kuadër siguron transparencë në procesin e regjistrimit të zgjedhësve dhe të administrimit të listave të zgjedhësve. Kuadri ligjor duhet të përcaktojë qartë metodën që duhet të ndiqet për të përcaktuar zgjedhësit me të drejtë vote, përfshi këtu dokumentacionin që kërkohet për të patur një proces krejtësisht transparent, i cili nuk është pre e vendimeve arbitrare dhe që mund të monitorohet objektivisht nga publiku.

Transparenca kërkon që listat zgjedhore të jenë dokumenta publike që vihen në dispozicion për verifikim, pa detyrimin për të paguar nga ana e kërkuarit. Kuadri ligjor duhet të përcaktojë qartë subjektin që ka të drejtë të bëjë verifikimin, mënyrë e kryerjes së këtij verifikimi dhe periudhën kohore gjatë së cilës listat zgjedhore do t'i vihen publikut për verifikim. Kuadri ligjor duhet të shprehet qartë rastet e përdorimit të informacionit të marrë nga verifikimi i listave të zgjedhësve dhe nëse informacioni mund të përdoret për qëllime të ndryshme nga kundërshtimi i regjistrimit të një zgjedhësi të caktuar. Në mënyrë të veçantë, ligji duhet të shprehet nëse informacioni mund të përdoret për veprimtari që lidhen me fushatën e partive politike dhe të kandidatëve. Kuadri ligjor duhet të shprehet gjithashtu mbi sanksionet që zbatohen kur informacioni

i marrë nga listat e zgjedhësve keqpërdoret. Ligji duhet të përcaktojë gjithashtu nëse listat e zgjedhësve duhet të përgatiten në një format elektronik, në rast se një gjë e tillë kërkohet.

Kuadri ligjor duhet të përcaktojë qartë se kush lejohet të kërkojë ndryshime të regjistrimit, shtesa dhe heqje emrash, mënyrën se si duhen bërë këto kërkesa dhe periudhën kohore të paraqitjes së tyre. Kërkesat për ndryshime, shtesa dhe heqje emrash në listat e zgjedhësve nuk duhet të kufizohen në një periudhë kohore para një zgjedhjeje të caktuar, me përjashtim të rasteve kur është e nevojshme që listat të përfundohen përpara zgjedhjeve. Asnjë person nuk duhet të kufizohet në bërjen një kërkesë që lidhet vetëm me atë person. Një person duhet lejuar të bëjë kërkesë në lidhje me një person tjetër, me kusht që ky i fundit të jetë njoftuar për këtë kërkesë dhe të ketë mundësinë t'i përgjigjet asaj. Për më tepër, kërkesat për ndryshime duhet të jenë të hapura për verifikim publik. Ndryshimet, shtesat dhe heqjet duhet të bëhen mbi bazën e paraqitjes së dokumentacionit të kërkuar dhe në përputhje me procedurën e përcaktuar në kuadrin ligjor. Vendimet mbi kërkesat duhet të merren pa vonesë, brenda periudhës kohore të përcaktuar me ligj. Vendimet e pabazuara duhet t'i nënshtrohen apelimit, dhe vendimet mbi këto apeline duhet të jepen menjëherë, brenda periudhës kohore të përcaktuar në mënyrë të veçantë me ligj.

Një sistem regjistrimi i votuesve mund të jetë aktiv ose pasiv. Përgjegjës për saktësinë e listave të zgjedhësve mund të jenë autoritetet vendore ose një autoritet shtetëror në nivel qendror. Megjithatë, analisti duhet të shohë me vemendje dispozitat që rregullojnë këtë çështje dhe të bindet se sistemi i përcaktuar me ligj siguron që listat e zgjedhësve administrohen në mënyrë të saktë dhe transparente dhe që mbron të drejtën për rregjistrim të qytetarëve që kanë mbushur moshën e kërkuar nga ligji dhe pengon regjistrimin e paligjshëm ose në rrugë të padrejtë.

Kuadri ligjor duhet të kërkojë gjithashtu që listat e zgjedhësve të përditësohen dhe korrigjohen në mënyrë sistematike dhe transparente, në një kohë të mjaftueshme përpara zgjedhjeve, në mënyrë që pjesëmarrësit dhe zgjedhësit të kenë mundësinë t'i rishikojnë ato për saktësi.

## **B.**

### **Mbrojtja e të Dhënave dhe e Informacionit Personal**

Përveç kërkesës për transparencë të plotë me qëllim mbrojtjen e integritetit të listave të zgjedhësve, ligji duhet të sigurojë mbrojtje të të dhënave dhe informacionit personal privat të grumbulluar gjatë një regjistrimit të zgjedhësve. Kuadri ligjor duhet të kërkojë që një person t'i japë një informacion të caktuar autoriteteve për qëllime të tilla

siç është regjistrimi si zgjedhës apo kandidat. Analisti duhet të rishikojë me kujdes kuadrin ligjor dhe të bindet se ai nuk lejon grumbullimin, përdorimin, apo përhapjen e të dhënave apo informacionit personal në asnjë mënyrë e për asnjë qëllim të ndryshëm nga ushtrimi i të drejtës së votës. Në mënyrë të veçantë, analisti duhet të shqyrtojë me vëmendje dispozitat që lidhen me shenjat e gishtërinjve, fotografitë dhe numrat personalë të identifikimit, si dhe me grupimin etnik apo faktorë të tjerë që mund të çojnë në diskriminimin e zgjedhësit apo mund ta ekspozojë atë ndaj rrezikut të dëmtimit personal. Analisti duhet të shohë gjithashtu me kujdes dhe të vlerësojë dispozitat ligjore që përcaktojnë se cili informacion e të dhëna personale të zgjedhësit duhet të botohen në listat zgjedhore.

### **LISTË KONTROLLI PËR REGJISTRIMIN DHE LISTAT E ZGJEDHËSVE**

- ✓ A siguron procesi i regjistrimit lista zgjedhësish të sakta dhe transparente?
- ✓ A janë kërkesat për regjistrimin e zgjedhësit të shprehura në një gjuhë të qartë dhe objektive?
- ✓ A përcakton qartë ligji se cilat dokumenta janë të nevojshme për një person që ai të regjistrohet si zgjedhës?
- ✓ A është e shprehur me një gjuhë të qartë dhe objektive procedura për kundërshtimin e një vendimi për regjistrim?
- ✓ A janë përcaktuar qartë periudha kohore për të kundërshtuar një vendim regjistrimi?
- ✓ A është zgjedhësi i mbrojtur nga nxjerrja gabimisht e të dhënave dhe e informacionit të tij personal?

## VIII.

# PARTITË POLITIKE DHE KANDIDATËT

**OBJEKTIVI:** Kuadri ligjor duhet të sigurojë që të gjitha partitë politike dhe kandidatët të jenë në gjendje të konkurojnë në zgjedhje mbi bazën e trajtimit të barabartë përpara ligjit.

### A.

## Trajtimi i Barabartë Përpara Ligjit

Kuadri ligjor duhet të sigurojë që të gjitha partitë politike dhe kandidatët të kenë mundësinë të konkurojnë në zgjedhje mbi bazën e trajtimit të barabartë përpara ligjit. Paragrafet 7.5 dhe 7.6 të Dokumentit të OSBE-së, Kopenhagen 1990 ilustrojnë më së miri këtë standart minimal.

Paragrafi 7.5 i Dokumentit të Kopenhagenit kërkon që shtetasit të lejohen “të kërkojnë funksione politike apo publike, individualisht ose si përfaqësues partish apo organizatash politike, pa u diskriminuar”. Kështu, kandidatët që kërkojnë funksione mund të lejohen të konkurojnë ose si kandidatë partie ose si kandidatë të pavarur. Përveç kësaj, kandidatët nuk mund të diskriminohen për shkak të anëtarësisë apo jo në ndonjë parti.

Paragrafi 7.6 i Dokumentit të Kopenhagenit kërkon që të respektohet e “drejta e individëve dhe grupeve për të krijuar lirisht partitë e tyre politike apo organizata të tjera politike,” dhe që qeveria “duhet t’u krijojë këtyre partive dhe organizatave politike garancitë ligjore të nevojshme për t’i lejuar ato të konkurojnë me njera tjetrën mbi bazën e trajtimit të barabartë përpara ligjit”. Një gjë e tillë kërkon që kuadri ligjor të ofrojë kushte të barabarta konkurimi për të gjitha partitë politike dhe kandidatët e angazhuar në proceset zgjedhore.

### B.

## Vendosja e Kandidatëve apo Partive në Fletën e Votimit

Një problem potencial që analisti duhet të rishikojë me kujdes është procesi i vendosjes së kandidatëve ose partive në fletën e votimit. Analisti duhet të rishikojë ligjin që rregullon krijimin dhe regjistrimin e partive politike për të përcaktuar nëse ka kërkesa të paarsyeshme për krijimin e një partie politike.

Megjithëse një kuadër ligjor mund të mos pengojë veprimtarinë e përgjithshme të partive politike apo kandidatëve të pavarur, ky kuadër mund të paraqesë pengesa për një parti politike apo kandidat të pavarur në vendosjen në fletën e votimit për një zgjedhje të caktuar. Një kuadër ligjor duhet të përcaktojë qartë të gjitha hollësitë për këtë çështje në lidhje me një lloj zgjedhje të caktuar. Këtu përfshihen data e fillimit dhe mbylljes së regjistrimit, periudha kohore dhe mënyra e mbledhjes së firmave në rastet kur regjistrimi përcaktohet nga firmat e mbledhura si dhe procesi i verifikimit të regjistrimit. Kur kuadri ligjor parashikon mbledhjen e firmave, ai duhet të përcaktojë gjithashtu një afat të mjaftueshëm kohor për këtë. Kuadri ligjor duhet të sigurojë njëtrajshmëri në procesin e regjistrimit, në mënyrë që i njëjti proces të zbatohet për të gjithë kandidatët në të gjitha nivelet.

Vendosja në fletën e votimit për një lloj të caktuar zgjedhjeje i lejonet zakonisht një partie politike, koalicioni, blloku politik apo kandidati të pavarur që plotëson një nga kërkesat e mëposhtme: (1) depozitimi i një shume të hollash, që i kthehet nëse subjekti merr një numër apo një përqindje të caktuar votash, (2) mbledhja e një numri minimal firmash nga zgjedhës të regjistruar, ose (3) sigurimi i një mandati apo i përqindjeje minimale votash nga zgjedhjet e fundit.

Pavarësisht nga procedurat që ndiqen për regjistrim, ai nuk duhet të lidhet me kërkesa të parëndësishme e që nuk kanë të bëjnë me çështjen nëse një parti politike apo kandidat i pavarur ka mbështetjen e mjaftueshme për t'u vendosur në fletën e votimit. Analisti duhet të shohë me kujdes kërkesat e regjistrimit. Arsyet për mospranimin e kërkesës për regjistrim duhet të bazohen në kritere objektive dhe të shprehura qartë në kuadrin ligjor.

Depositat në të holla duhet të jenë në sasi të mjaftueshme për të dekurajuar partitë politike dhe kandidatët e pavarur jo seriozë, por ato nuk duhet të jetë aq të larta sa të pengojnë partitë politike ose kandidatët e pavarur legjitimë të vendosen në fletën e votimit. Për më tepër, këto depozita duhet të kthehen pas marrjes së një numri apo përqindjeje të caktuar votash. Pragu që përcaktohet për kthimin e kësaj depozite monetare duhet të jetë i arsyeshëm.

Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet mënyrës se si përcaktohet vlefshmëria e firmave. Një firmë e pavlefshme duhet të jetë thjesht ashtu si është – një firmë e pavlefshme. Një firmë e pavlefshme nuk zhvlerëson firmat e tjera apo listën e firmave. Përveç kësaj, në vend që një kandidati t'i kërkohet të sjellë një përqindje të caktuar firmash të vlefshme (*p.sh.* 99%), atij duhet t'i kërkohet që të paraqesë një numër të caktuar firmash të vlefshme (*p.sh.* 1,000) dhe të lejonet që të paraqesë firma shtesë në rast se disa nga firmat konsiderohen të pavlefshme. Shembulli i mëposhtëm, i marrë nga një ligj konkret zgjedhor, ilustron përse, kur kërkohet mbledhja e firmave, regjistrimi duhet të bazohet në përcaktimin e një numri të caktuar firmash të vlefshme, pa marrë parasysh numrin apo përqindjen e firmave të pavlefshme që mund të jenë në listën e regjistrimit.

Le të mendojmë se një kandidati për deputet i duhen të paktën 1,000 firma të vlefshme për të plotësuar kërkesat për kandidim. Kandidati B është jashtëzakonisht i njohur dhe merr 2,500 firma në mbështetje të tij. Nga këto 2,500 firma, 2,130 janë të vlefshme dhe 370 janë të pavlefshme. Sipas procedurës së verifikimit që aplikohet në vend, kontrollohen 875 firma, nga të cilat 699 janë të vlefshme dhe 176 të pavlefshme. Megjithatë, tani ligji parashikon se verifikimi i mëtejshëm i firmave në listat e firmave përfundon, pasi numri i firmave të pavlefshme që janë gjetur gjatë verifikimit përbën më shumë se 15 përqind të numrit të përgjithshëm të firmave të verifikuara në listat e firmave. Rezultati përfundimtar është se një kandidat, i cili ka 2,130 firma të vlefshme, kur atij i nevojiten vetëm 1,000 firma, nuk lejohet të jetë kandidat. Ky shembull është dhënë për të treguar se është shumë e rëndësishme që analisti të kontrollojë me kujdes dispozitat ligjore që lidhen me mbledhjen e firmave dhe verifikimin e tyre.

Procedurat për verifikimin e firmave mund të krijojnë mjaft hapësira për abuzim. Një listë e paraqitur për verifikim nga një parti apo kandidat mund të kontrollohet deri në detaje, ndërsa një listë tjetër miratohet pa u kontrolluar fare. Ligji për zgjedhjet duhet të përcaktojë se si duhen verifikuar firmat dhe të bëjë të qartë se kjo procedure zbatohet në mënyrë të barabartë për të gjitha listat. Po aq e rëndësishme është që ligji të përcaktojë me sa hollësi do të verifikohen firmat. Listat e firmave mund të kontrollohen për gabime në paraqitjen e dokumentit (i njëjti zgjedhës ka nënshkruar dy herë, ose një zgjedhës nuk ka shkruar adresën e tij kur kjo kërkohet). Ligji duhet të qartësojë shumë mirë se çfarë procesi verifikimi ndiqet për të siguruar që të gjitha listat i nënshtohen të njëjtit kontroll, sipas kriterëve objektive të shprehura qartë.

Analisti duhet të pyesë nëse ligji parashikon një protokoll për kontrollin e firmave, i cili është funksional përsa i përket kontrollit statistikor të cilësisë. Ky protokoll duhet të përcaktojë të paktën:

- madhësinë e kampionit që duhen nxjerrë dhe kontrolluar;
- metodën e nxjerrjes së një kampioni (kjo duhet të përfshijë një përzgjedhje kompjuterike numrash të rastësishme);
- provat që duhen bërë për të përcaktuar nëse një firmë është e vlefshme apo jo;
- një formulë për të caktuar numrin e firmave në kampion, të cilat duhet të jenë të vlefshme në mënyrë që regjistrimi të jetë i pranueshëm; dhe,
- po të jetë nevoja, rrethanat në të cilat mund të merret një kampion tjetër.



Gjithashtu, duhen rishikuar me kujdes edhe dispozitat në lidhje me rajonet gjeografike ku janë marrë firmat. Një ligj për zgjedhjet mund të kërkojë që një parti të fitojë një numër të caktuar firmash në çdo rajon të vendit. Një dispozitë e tillë diskriminon partitë që gëzojnë një mbështetje të madhe publike, por të kufizuar në një rajon të caktuar. Një dispozitë e tillë mund të diskriminojë gjithashtu partitë e vogla dhe pakicat.

Problematike mund të jetë edhe kërkesa që zgjedhësit lejohen të nënshkruajnë vetëm në mbështetje të një kandidati apo partie të vetme. Në raste të tilla, një kandidat i cili ka mbledhur në mirëbesim numrin e kërkuar të firmave mund të skualifikohet jo për ndonjë faj të tij, por sepse zgjedhësit kanë nënshkruar më shumë se një peticion. Në rastin më të keq, zgjedhësit mund të nënshkruajnë qëllimisht më shumë se një peticion në përpjekje për të skualifikuar një kandidat.

Gjithashtu duhen përcaktuar afatet brenda të cilave autoriteti regjistruar do të miratojë apo kundërshtojë kërkesat për regjistrim. Arsyet për kundërshtim duhen shprehur qartë në ligj dhe të bazohen në kritere objektive. Ligji duhet të lejojë gjithashtu korrigjimin e mangësive të vogla brenda një afati të arsyeshëm kohor pas kundërshtimit të një kërkesë. Ligji duhet të lejojë apelimin në një gjykatë pas refuzimit përfundimtar të një regjistrimi. Gjithashtu, ligji duhet të përcaktojë qartë procesin e ankimimit dhe të kërkojë një vendim-marrje të shpejtë nga ana e gjykatës, për t'i krijuar mundësi një kandidati apo partie të marrë pjesë në zgjedhje kur regjistrimi i tij është refuzuar pa të drejtë.

Sapo një regjistrim miratohet, problemi i regjistrimit apo mundësia për çregjistrim nuk duhet të jetë ekzistojë më. Me qëllim që të evitohen spekulimet dhe abuzimi në lidhje me një çregjistrim të mundshëm, mundësia për të anuluar regjistrimin për një parti politike apo kandidat duhet të jetë shumë e vogël, duke lejuar një rishikim të regjistrimit vetëm në rast se ka shkelje serioze të ligjit dhe në përputhje me procedura të shprehura qartë.

Analisti duhet të vlerësojë të gjitha dispozitat që rregullojnë regjistrimin, përfshi këtu vlerën e depozitës në të holla ose numrin e firmave të kërkuara, brenda kontekstit të vendit, *p.sh.*, duke marrë në konsideratë realitetet ekonomike dhe demografike.

### **C.**

## **Qëndrimi i Partive Politike dhe Kandidatëve Gjatë Fushatave Zgjedhore**

Kuadri ligjor duhet të shprehë me një gjuhë të qartë se cilat sjellje u lejohen partive politike dhe kandidatëve gjatë fushatave zgjedhore dhe cilat jo. Dispozita që rregullojnë sjelljen e partive politike dhe kandidatëve mund të gjenden në ligjin penal dhe/ose në ligjin për zgjedhjet. Këto dispozita nuk duhet të jenë shumë kufizuese dhe duhet të krijojnë mundësinë për një fushatë aktive e të hapur, të lirë nga nderhyrjet e qeverisë. Shembuj të

kodeve model të sjelljes për partitë politike dhe kandidatët gjatë fushatave zgjedhore janë përfshirë në seksionin e Kodeve Model të Shtojcës.

## **D. Problem i Veçantë në Lidhje me Përfundimin Para Kohe të Mandatit të një Kandidati**

Një problem i veçantë për të cilin analisti duhet të jetë i vetëdijshëm është rasti kur një kuadër ligjor lejon përfundimin para kohe të mandatit të një kandidati për shkak të ndryshimit të mbështetjes se tij nga një parti tjetër politike. Një kandidat i zgjedhur duhet të jetë i përgjegjshëm para elektoratit. Kjo përgjegjësi mund të dëmtohet në rast se kuadri ligjor kërkon që një kandidat, i cili ka ndryshuar përkatësinë e tij partiake, të dorëzojë para kohe mandatin e tij. Kjo dispozitë ligjore krijon gjithashtu mundësi për abuzim nga drejtuesit e partive politike.

### **LISTË KONTROLLI PËR PARTITË POLITIKE DHE KANDIDATËT**

- ✓ A u është siguruar të gjitha partive politike dhe kandidatëve trajtim i barabartë përpara ligjit?
- ✓ A u është siguruar kandidatëve e drejta për të kërkuar një funksion ose si kandidatë të një partie politike ose si kandidatë të pavarur?
- ✓ A krijon kuadri ligjor kushte të barabarta konkurimi për të gjitha partitë politike dhe kandidatët?
- ✓ A janë bazuar kërkesat e kandidatëve që do të marrin pjesë në zgjedhje në kritere të përshtatshme, të arsyeshme, objektive dhe të shprehura qartë në ligj?
- ✓ A janë procedurat për regjistrimin e një kandidati të arsyeshme dhe të shprehura qartë me një gjuhë objektive në ligj?
- ✓ A siguron kuadri ligjor rishikim gjyqësor të vendimeve për regjistrimin e kandidatit?
- ✓ A rregullon ligji qëndrimin e partive politike dhe kandidatëve gjatë fushatave zgjedhore dhe a siguron ai një fushatë aktive dhe të hapur larg ndërhyrjes së qeverisë?
- ✓ A e mbron kuadri ligjor përfundimin e parakohshëm të mandatit të një kandidati të zgjedhur për shkak të ndryshimit të përkatësisë së tij partiake?

## IX.

# TRAJTIMI I BARABARTË DHE AKSESI NË MEDIA

**OBJEKTIVI:** Kuadri ligjor duhet të sigurojë që të gjitha partitë politike dhe kandidatët të kenë akses në media dhe trajtim të barabartë në mediat që zotërohen apo kontrollohen nga shteti dhe se liria e shprehjes e partive politike dhe kandidatëve gjatë fushatave zgjedhore nuk i nënshtrohet kufizime të paarsyeshme.

### A.

## Trajtimi i Barabartë dhe Aksesit

Partive politike dhe kandidatëve duhet t'u krijohet mundësia për të patur akses në media dhe trajtim të barabartë në mediat që zotërohen apo kontrollohen nga shteti, në mënyrë që zgjedhësit të mund të informohen për platformat politike, pikëpamjet dhe objektivat në mënyrë të ndershme dhe të paanshme. Këtu përfshihen të gjitha format e mediave, radio, televizioni, gazetat dhe forma të tjera të zhvilluara të medias siç është Interneti.

Paragrafet 7,6 dhe 7,8 të Dokumentit të OSBE-së, Kopenhagen 1990 ilustrojnë këtë standart minimal. Paragrafi 7,6 kërkon që qeveria t'u sigurojë partive dhe organizatave politike "garancitë ligjore të nevojshme për t'i mundësuar ato të konkurrojnë me njëra-tjetrën mbi bazën e trajtimit të barabartë përpara ligjit dhe autoriteteve". Paragrafi 7,8 kërkon nga qeveria të sigurojë që "asnjë pengesë ligjore apo administrative të mos pengojë aksesin e lirë në media, në mënyrë jo diskriminuese, për të gjithë grupimet politike dhe individët që dëshirojnë të marrin pjesë në procesin zgjedhor." Kuadri ligjor i një vendi duhet t'i përmbajë këto garanci si dhe një proces të përcaktuar qartë për zbatimin në kohë të këtyre garancive para dhe gjatë zgjedhjeve. Procesi i krijimit të një formule apo grafiku për akses në media dhe trajtim të barabartë nga ajo për një proces të caktuar zgjedhor duhet të jetë i kuptueshëm dhe objektivisht i zbatueshëm.

Një praktikë që mund të sigurojë këtë standart është kërkesa për t'u dhënë partive politike të drejtën e një kohe të lire në radion dhe televizionin publik mbi një bazë të përhershme dhe jo vetëm gjatë periudhave zgjedhore. Një kuadër ligjor që siguron se të gjitha partive politike u garantohet një numër i caktuar minutazhi për transmetim në muaj, mund të çojë në zbatimin e kësaj praktike. Në mënyrë ideale, gjatë fushatave zgjedhore, partive politike dhe kandidatëve t'u caktohet një kohë e lirë shtesë në mënyrë që ata të transmetojnë informacionin rreth kandidaturave të tyre.

Koha e lirë e transmetimit ose një hapësirë e lirë për të shkruar në gazetë gjatë periudhave zgjedhore duhet të ndahet sipas një formule të caktuar që mund të zbatohet objektivisht. Zbatimi objektiv sigurohet në rast se ligji përcakton përqindjen që do t'u shpërndahet partive politike dhe kandidatëve mbi një bazë të barabartë, pavarësisht nga fuqia parlamentare. Rekomandohet gjithashtu që sasia e kohës së transmetimit, e shpërndarë mbi një bazë të barabartë, të jetë e mjaftueshme për t'u siguruar partive politike dhe kandidatëve një konkurim të efektshëm në zgjedhje.

Edhe për reklamën politike me pagesë duhet gjithashtu të ketë garanci për akses dhe trajtim të barabartë. Në fushën e reklamës politike të paguar krijohen pabarazi në rast se kuadri ligjor nuk siguron që e njëjta tarifë tregtare për të tilla reklama u ofrohet të gjitha partive politike dhe kandidatëve dhe që koha e vendosja e reklamës të jenë në kushte të ngjashme. Në mënyrë alternative dhe kur nuk bie ndesh me ligje të tjera, kuadri ligjor mund të ndalojë të gjitha reklamat politike me pagesë. Në rast se reklamat politike me pagesë lejohen, atëherë për këto reklama duhet të ofrohen të njëjtat kushte dhe tarifa tregtare për të gjitha partitë politike dhe kandidatët, me qëllim që të garantohet akses dhe trajtim i barabartë. Për më tepër, reklama politike me pagesë duhet të identifikohet si e tille dhe nuk duhet të paraqitet si lajm apo editorial.

Rregullimi i trajtimit i barabartë dhe aksesit në media mund të bëhet me një ligj të vendit për median ose informacionin publik. Gjithashtu, ligji mund të përmbajë vetëm rregullime të përgjithshme mbi trajtimin e barabartë dhe aksesin dhe mund t'ja delegeje autoritetin për nxjerrjen e akteve nënligjore të posaçme për zbatim të dispozitave një organi administrativ siç mund të jetë një komision i specializuar i medias. Pavarësisht se një rregullim i tillë bëhet me statut apo dispozita administrative, monitorimi i medias rekomandohet me qëllim që të sigurohet zbatimi i normave. Ligji dhe zbatimi i tij nuk duhet t'i krijojë një avantazh të pamërituar një partie të caktuar politike apo kandidati të veçantë.

Standarti i trajtimit të barabartë dhe aksesit në media dëmtohet në rast se media e zotëruar apo e kontrolluar nga shteti është në gjendje të favorizojë një parti politike apo kandidat në edicionet e lajmeve, programet politike, debatet apo editorialet. Trajtimi apo shprehja e njëanshme në median shtetërore nuk duhet të lejohet dhe autoriteteve duhet t'u kërkohet që të veprojnë menjëherë në çdo rast shkeljeje.

## B.

### **Kufizimet në Lirinë e Shprehjes Gjatë Fushatave Zgjedhore**

Zgjedhjet demokratike janë të pamundura kur kuadri ligjor ndalon apo frenon lirinë e shprehjes dhe fjalës në fushata. Shumë shpesh, kuadri ligjor në një vend që po kalon nga tranzicioni në demokraci, çensuron fjalimet në fushata duke vendosur sanksione

për fjalime që “shpifin” apo “fyejnë” një person tjetër, që mund të pëfshijnë qeverinë, qeveritarë, apo kandidatë në fushatë zgejdhore. Të tilla dispozita gjenden shpesh në kodin zgjedhor apo ligjin për median (informimin publik). Megjithatë, analisti duhet të studjojë thellësisht kuadrin ligjor, pasi këto dispozita gjenden edhe në ligjet e përgjithshme kushtetuese, civile, penale dhe administrative.

Çdo ligj që trajton shpifjen ndaj karakterit apo reputacionit të një personi, duhet të përfshihet vetëm në ligjin civil që është në fuqi. Përfshirja në ligjin zgjedhor e një dispozite që rregullon shpifjen nuk është e justifikueshme, prandaj analisti duhet të bëjë komente. Analisti duhet të propozojë gjithashtu ndryshimin e çdo dispozite, pavarësisht nga burimi ligjor, që kërkon heqjen e të drejtës së kandidimit apo parashikon burgim ose joba në të holla për “shpifjen” ndaj një kandidati apo partie politike.

Kufizime të tilla në lirinë e shprehjes shkelin ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Gjithashtu, dispozita të tilla zakonisht shkelin garancitë për lirinë e shprehjes që përfshihen në kushtetutën e një vendi. Kur analisti rishikon dispozitat që lejojnë censurimin e kandidatëve, mbështetësve, apo të shtypit dhe medias, ai duhet të theksojë se dispozita të tilla janë në kundërshtim me standartet ndërkombëtare dhe, kur është rasti, me ligjin e brendshëm të atij vendit. Megjithatë, ky standart nuk është i zbatueshëm për ndalimin e fjalimeve provokuese që synojnë të provokojnë një person tjetër të ushtrijë dhunë.

Ilustrim i këtij standarti minimal është Paragrafi 7.7 i Dokumentit të OSBE-së, Kopenhagen 1990. Paragrafi 7.7 kërkon që “ligji dhe politikat publike të kontribuojnë në zhvillimin e fushatës politike në një klimë të ndershme dhe të lirë, në të cilën as veprimi administrativ, as dhuna apo frikësimi, të mund të ndalojnë partitë dhe kandidatët të paraqesin lirisht pikëpamjet dhe cilësitë e tyre, ose të mund të pengojnë zgjedhësit të informohen dhe të diskutojnë rreth tyre ...” Dispozitat ligjore që kufizojnë lirinë e fjalës dhe të shprehjes në një fushatë politike mund të jenë gjithashtu në kundërshtim me instrumentat ndërkombëtare që vendi ka nënshkruar. Kështu, çdo kufizim i fjalës apo i shprehjes gjatë fushatave zgjedhore duhet të shihet me hollesi nga analisti.

### **LISTË KONTROLLI PËR TRAJTIMIN E BARABARTË DHE AKSESIN NË MEDIA**

- ✓ A u siguron kuadri ligjor partive politike dhe kandidatëve akses dhe trajtim të barabartë në median e zotëruar apo kontrolluar nga shteti?
- ✓ A siguron kuadri ligjor një formulë për akses dhe trajtim të barabartë, të drejtë, të kuptueshëe dhe që të mund të zbatohet objektivisht?
- ✓ A siguron kuadri ligjor liri shprehjeje gjatë fushatave zgjedhore?

## X. FINANCIMI DHE SHPENZIMET PËR FUSHATËN

**OBJEKTIVI:** Kuadri ligjor duhet të sigurojë që të gjitha partitë politike dhe kandidatët të trajtohen njëllorj përpara ligjit përmes dispozitave ligjore që rregullojnë financimin dhe shpenzimet për fushatën.

### A. Fondet Publike

Në rast se kuadri ligjor parashikon financime publike, atëherë fondet publike duhet të jepen mbi bazën e një trajtimi të barabartë përpara ligjit. Kjo nuk do të thotë se të gjitha partitë politike dhe kandidatët do të marrin të njëjtën sasi fondesh për fushatën. Kjo nënkupton vetëm se partitë politike dhe kandidatët duhet të marrin fonde publike mbi bazën e një trajtimi të barabartë përpara ligjit. Standarti minimal i paraqitur në kapitullin e mëparshëm mbi Trajtimin e Barabartë dhe Aksesin në Media është i zbatueshëm në rast se fondet publike vërtet parashikohen nga kuadri ligjor.

Çdo dispozitë për financime publike duhet të shprehet qartë në ligj dhe të bazohet në kriteret objektive që nuk lënë hapësirë për interpretim subjektiv nga autoritetet qeveritare. Përveç kësaj, kuadri ligjor duhet të sigurojë që burimet shtetërore të mos keqpërdoren për qëllime fushate, por të shfrytëzohen vetëm në përputhje të plotë me dispozitat ligjore në fuqi. Analisti duhet të rishikojë me kujdes kuadrin ligjor për t'u siguruar që zyrtari i zgjedhur në detyrë të mos kenë asnjë avantazh nga përdorimi i burimeve shtetërore. Kuadri ligjor duhet të shprehë në mënyrë veçantë se të gjitha burimet shtetërore të përdorura për qëllime fushate, si për shembull media, ndërtesat, pasuritë dhe burimet e tjera shtetërore, vihen në dispozicion të të gjithë pjesëmarrësve në zgjedhje mbi bazën e trajtimit të barabartë përpara ligjit.

### B. Fondet Private

Çdo kufizim në financimin privat të fushatave politike duhet të shtyrtohet me kujdes. Çdo lloj pengese apo kufizimi në financimin privat mund të konsiderohet shkelje e të drejtave të njeriut për t'u organizuar ose për t'u shprehur lirisht. Kështu, analisti duhet të vlerësojë me vëmendje dispozitat ligjore që rregullojnë financimin privat të

fushatave politike. Analisti duhet të theksojë gjithashtu papërshtatshmërinë e një kuadri ligjor që përcakton se fushatat zgjedhore duhet të financohen krejtësisht nga shteti.

Analisti duhet të shohë me kujdes dispozitat ligjore që përpichen t'i kanalizojnë financimet private drejt partive apo kandidatëve të veçantë. Një gjë e tillë zakonisht gjendet në një kuadër ligjor që ndalon kontributet e drejtpërdrejta private për partitë politike apo kandidatët dhe në vend të tyre, kërkon që kontributet private të depozitohen në një fond "publik" prej nga ato u shpëndohen partive politike dhe kandidatëve sipas një formule shpërndarjeje qeveritare. Një dispozitë e tillë i kërkon në fakt një kontribuesi privat të mbështesë "armiqtë" në qoftë se kontribuesi dëshiron të mbështesë një "mik".

Megjithëse kuadri ligjor duhet të lejojë financimin privat të fushatave politike, janë të lejueshme kufizime të arsyeshme mbi sasinë e kontributeve private. Ajo që konsiderohet e arsyeshme varet nga lloji i zgjedhjeve dhe faktorët që janë unikë për një vend të caktuar, si p.sh. gjeografia, demografia, kosto relative e medias dhe e materialeve të tjera të fushatës.

Është i pranueshëm gjithashtu kufizimi i sasisë së *përgjithshme* të shpenzimeve të konkuresve zgjedhore në një fushatë të caktuar. Megjithëse kuadri ligjor duhet të lejojë konkuresit zgjedhorë të shpenzojnë burimet e *mjaftueshme* për të transmetuar një mesazh politik, nuk ka ndonjë standart minimal që kërkon që konkuresve zgjedhorë t'u jepet mundësia për të blerë zgjedhjet.

## C. Kërkesat për Raportim dhe Publikim

Kufizimet e ligjshme në shpenzimet për fushatën nuk kanë kuptim pa kërkesën për raportimin dhe publikim. Kështu, kuadri ligjor duhet të kërkojë një raportim periodik, që bëhet në intervale të arsyeshëm kohorë, për të gjitha kontributet e marra dhe shpenzimet e bëra nga një konkures në zgjedhje. Megjithatë, analisti duhet të jetë realist për kërkesat e raportimit për çdo demokraci në tranzicion. Për më tepër, çdo sanksion për mosraportim apo për raportim të një informacioni të gabuar duhet të shprehet në kuadrin ligjor dhe duhet të jetë në përputhje me shkëlqen e bërë. Për shembull, kandidatët nuk duhet të skualifikohen nga pjesëmarrja në zgjedhje për parregullsi të vogla raportimi.

Kuadri ligjor duhet të përcaktojë në mënyrë të veçante agjencinë e ngarkuar me marrjen dhe ruajtjen e raporteve për kontributet dhe shpenzimet e fushatës. Kuadri ligjor duhet të qartësojë mirë se ku dhe kur këto raporte janë gati për inspektim publik. Ligji duhet të lejojë gjithashtu shumëfishimin e raporteve mbi kontributet dhe shpenzimet për fushatë, në mënyrë që përmbajtjet e tyre të mund t'u shpërndahen zgjedhësve.



**LISTË KONTROLLI PËR FINANCIMIN DHE SHPENZIMET PËR FUSHATËN**

- ✓ A u siguron kuadri ligjor të gjitha partive politike dhe kandidatëve trajtim të barabartë përpara ligjit me dispozita që rregullojnë financimet dhe shpenzimet për fushatën?
- ✓ Në rast se kuadri ligjor parashikon financimin publik apo përdorimin e burimeve shtetërore për fushatat, a parashikon ai për këtë përdorim trajtim të barabartë përpara ligjit për të gjitha partitë politike dhe kandidatët?
- ✓ A janë të arsyeshme, të qarta dhe të përshtatshme për një zbatim objektiv kufizimet për financimin privat të fushatave?
- ✓ A kërkon kuadri ligjor raportim periodik mbi kontributet dhe shpenzimet për fushatën?
- ✓ A siguron kuadri ligjor akses të publikut në raportet mbi kontributet dhe shpenzimet për fushatën?

## XI. VËZHguesIT

**OBJEKTIVI: Kuadri ligjor duhet të garantojë që vëzhguesit, përfshi ata vendas dhe të huaj, përfaqësues të medias, parti politike dhe kandidatë, të sigurojnë transparencë në të gjitha proceset zgjedhore.**

Transparenca e procesit zgjedhor është një standart minimal i nevojshëm për të siguruar zgjedhje demokratike. Ilustrim i këtij standarti minimal është paragrafi 8 i Dokumentit të OSBE-së Kopenhagen 1990, që çmon rëndësinë e pranisë së vëzhguesve, vendas dhe të huaj, për sigurimin e transparencës në procesin zgjedhor. Kuadri ligjor duhet të sigurojë praninë e vëzhguesve, vendas dhe të huaj dhe të përfaqësuesve të medias, partive politike dhe kandidatëve për të garantuar transparencë gjatë gjithë proceseve zgjedhore. Kuadri ligjor nuk duhet t'u kufizojë agjentëve apo përfaqësuesve të partive politike dhe kandidatëve të drejtën për të vëzhguar. Media dhe vëzhguesit e organizatave joqeveritare kanë një rol të rëndësishëm në shtimin e transparencës së proceseve zgjedhore dhe duhet të kenë të drejtën e akreditimit për vëzhgim. Megjithatë, në raste të veçanta ku vetë akti i votimit paraqet rreziqe të mëdha për zgjedhësit, disa kufizime mund të jenë të përshtatshme. Për aq sa e lejon koha dhe burimet, analisti duhet të rishikojë ligjin që zbatohet për organizatat jo-qeveritare dhe shoqatat publike, për të garantuar se këto ligje nuk vendosin kërkesa të paarsyeshme për marrjen e një statusi ligjor të nevojshëm për të aplikuar si vëzhgues në proceset zgjedhore.

Kuadri ligjor duhet të parashikojë kritere të qarta dhe objektive për kërkesat për regjistrimin e një vëzhguesi. Kuadri ligjor duhet të qartësojë gjithashtu se cili autoritet qeveritar akrediton vëzhguesit, cilat janë kërkesat për të marrë statusin e vëzhguesit dhe në çfarë rrethanash mund të revokohet ky status.

Kuadri ligjor duhet të jetë i qartë dhe i saktë në lidhje me të drejtat e vëzhguesve. Një dispozitë e përgjithshme që lejon vëzhguesit të "vëzhgojnë zhvillimin e zgjedhjeve" nuk është e mjaftueshme. Ligji duhet të përmbajë dispozita të qarta e të sakta ku të përcaktohen të drejtat e vëzhguesve për të inspektuar dokumentet, për të ndjekur mbledhjet, për të monitoruar aktivitetet zgjedhore në të gjitha nivelet e në cdo kohë, përfshi këtu numërimin e votave dhe shpalljen e rezultateve si dhe për të marrë kopjet e protokolleve në të gjitha nivelet. Ligji duhet të përcaktojë edhe një proces të përsheptuar për të gjetur një zgjidhje të përshtatshme për vëzhguesit, kur një komision/organ zgjedhor i mohon atij të drejtat si vëzhgues, përfshi të drejtën për t'u regjistruar si vëzhgues vendas.

Kuadri ligjor duhet të jetë gjithashtu i qartë dhe i saktë në lidhje me veprimet që një vëzhgues vendas *nuk* mund të kryejë, p.sh. ndërhyrja në votim, çdo pjesëmarrje e drejtpërdrejtë në procesin e votimit apo numërimit, ose përpjekje për të përcaktuar se si një zgjedhës duhet të votojë ose ka votuar. Kuadri ligjor duhet të sigurojë se vetëm vëzhguesit që veprojnë në mirëbesim duhet të lejohen të vëzhgojnë veprimtaritë zgjedhore. Kuadri ligjor duhet të balancojë të drejtat e vëzhguesve dhe një administrim të rregullt të proceseve zgjedhore. Kështu, kërkesat për regjistrim për të vëzhguar qendra të veçanta zgjedhore mund të jenë të përshtatshme. Përsëri, analisti duhet të rishikojë me kujdes çdo kërkesë që mund të vështirësojë punën e vëzhguesve dhe shërben për të penguar një vëzhgim të ligjshëm. Kjo lidhet veçanërisht me ato dispozita që përpiqen “t’u mbyllin gojën” vëzhguesve apo t’i pengojnë ata të raportojnë ose të japin informacionin që kanë marrë gjatë punës së tyre si vëzhgues.

Shembuj të kodeve model të sjelljes të vëzhguesve janë të përfshirë në seksionin e Kodeve Model të Shtojcës.

### LISTË KONTROLLI E ANALISTIT PËR VËZHGUESIT

- ✓ A i lejon kuadri ligjor vëzhguesit vendas dhe të huaj të vëzhgojnë të gjitha proceset zgjedhore?
- ✓ A i lejon kuadri ligjor përfaqësuesit e medias, partive politike dhe kandidatëve të vëzhgojnë të gjitha proceset zgjedhore?
- ✓ A siguron kuadri ligjor kritere të qarta dhe objektive për kërkesat për t’u regjistruar si vëzhgues?
- ✓ A është kuadri ligjor i qartë në lidhje me organin qeveritar që akrediton vëzhguesit?
- ✓ A është kuadri ligjor i qartë në lidhje me të drejtat e vëzhguesve dhe me kohën se kur e në çfarë rrethanash mund të revokohet statusi i një vëzhguesi?
- ✓ A vendos kuadri ligjor një ekuilibër midis të drejtave të vëzhguesve dhe administrimit të rregullt të zgjedhjeve?
- ✓ A ka kërkesa ligjore që mund të vështirësojnë punën e vëzhguesve dhe shërben për të penguar një vëzhgim të ligjshëm?

## XII. PROCEDURAT E VOTIMIT

**OBJEKTIVI:** Kuadri ligjor duhet të sigurojë garantimin e votës së fshehtë dhe se të gjitha votat numërohen dhe protokollohen në mënyrë të barabartë, të drejtë dhe transparente.

### A. Fshehtësia e votës

Fshehtësia e votës është një standart minimal në zgjedhjet demokratike. Ilustrim i këtij standarti minimal është Paragrafi 7.4 i Dokumentit OSBE-së, Kopenhagen 1990, sipas të cilit votimi të bëhet i fshehtë.

Analisti duhet të kontrollojë me kujdes ato dispozita të kuadrit ligjor që lidhen me kontrollin dhe sigurinë e votës, si dhe dispozitat që rregullojnë hedhjen e votës në një qendër votimi. Kuadri ligjor duhet të parashikojë sigurimin e votës, e në të njëjtën kohë të garantojë se nuk mund të identifikohet votuesi i cili ka hedhur një fletë votimi të veçantë.

Në asnjë rast nuk duhet lejuar që një anëtar i komisionit të qendrës së votimit apo një person tjetër të shohë fletën e votimit të plotësuar nga zgjedhësi, përveçse gjatë numërimit të votave pas mbylljes së votimit. Është e qartë se një dispozitë e tillë nuk zbatohet për një person ligjërisht të autorizuar për të ndihmuar një zgjedhës të verbër ose një zgjedhës i cili ka nevojë për ndihmë për shkak të paaftësisë fizike. Megjithatë, është e papranueshme që një anëtar i komisionit të qendrës së votimit të marrë në dorë apo të kontrollojë fletën e plotësuar të votimit të një zgjedhësi përpara se ajo të jetë futur në kutinë e votimit.

Parimi i votimit të fshehtë kërkon që rregullat mbi zgjedhjet të theksojnë se votimi i fshehtë është jo vetëm një e drejtë e zgjedhësit, por edhe një detyrim absolut. Në lidhje me këtë, abuzimi më i shpeshtë është “votimi familjar”, i cili është ende një praktikë relativisht e zakonshme në shumë vende të OSBE-së. Legjislacioni duhet të bëjë të qartë se vota e çdo zgjedhësi duhet të plotësohet dhe hidhet në fshehtësi. Zyrtarët zgjedhorë nuk duhet në asnjë rast të pranojnë shmangie nga parimi i votimit të fshehtë.

## B. Procedurat e votimit

Analisti duhet të shohë me vëmendje të gjitha procedurat që rregullojnë procesin e votimit. Procedurat e votimit duhet të sigurojnë identifikimin e zgjedhësve në mënyrën e duhur dhe funksionimin e mekanizmave të tjerë për të mos lejuar votim mashtrues apo të dyfishtë. Megjithatë, procedurat e votimit nuk duhet të jenë të lodhshme apo të ndërlikuara në atë masë sa të pengojnë procesin e votimit. Procedurat e votimit duhet të sigurojnë se të gjitha fletët e votimit dhe materialet e votimit janë të ruajtura mirë, para, gjatë dhe pas votimit.

Analisti duhet të rishikojë me kujdes në qoftë se dhe si kuadri ligjor ofron metoda të tjera votimi, për shembull votim me postë apo votim të lëvizshëm. Që të dyja tipet e votimit mund të vihen në dispozicion të një individi, p.sh. një person që është jashtë shtetit me shërbim, ose për një komunitet të tërë, si p.sh. për persona të zhvendosur për shkak të shpërthimit të një lufte. Votimi i lëvizshëm mund të vihet në dispozicion edhe për një votues që qëndron në shtëpi për shkak të paaftësisë së tij fizike, apo për një komunitet të tërë, siç mund të jetë një spital apo institucion. Kuadri ligjor mund të sigurojë dispozita të posaçme votimi për anëtarët e forcave ushtarake. Analisti duhet të rishikojë me kujdes të gjitha dispozitat për gjetur metoda të tjera votimi dhe të sigurohet se ekzistojnë mekanizma të përshtatshëm për të parandaluar abuzimin me metodat e tjera të votimit. Analisti duhet të shohë me vëmendje kuadrin ligjor për t'u siguruar se ekzistojnë mekanizma që pengojnë një person të përdorë një metode tjetër votimi dhe procesin e rregullt të votimit në të njëjtat zgjedhje.

Kuadri ligjor duhet të ndalojë praninë e personave të paautorizuar në qendrat e votimit. Në mënyrë të veçantë, autoritetet ekzekutive vendore nuk duhet të jenë gjithmone të pranishëm dhe të gatshëm për të zgjidhur çdo "vështiresi" që mund të paraqitet gjatë proceseve zgjedhore. Pra është e nevojshme të rekomandohet, në rast se nuk është përfshirë në kuadrin ligjor, ndalimi kategorik i pranisë së personave të paautorizuar në qendrat e votimit. Kjo mund të shoqërohet në mënyrë të dobishme me një dispozitë ku të theksohet se oficerët e policisë duhet të hyjnë në qendrat e votimit vetëm për të votuar në mënyrë të rregullt ose për të vendosur rendin. Në rastin e fundit, policia duhet të hyjë vetëm kur ajo thirret nga kryetari i komisionit të qendrës së votimit, ose nga një person që vepron në emër të tij dhe duhet të largohet sapo të jenë vendosur rregulli.

## C. Votimi i Lëvizshëm

Është e zakonshme që një ligj për zgjedhjet të parashikojë votimin e lëvizshëm për personat e paaftë fizikisht ose për ata që nuk mund të vijnë në qendrën e votimit për

shkaqe të tjera të arsyeshme. Parimi i krijimit të kushteve të përshtatshme për zgjedhësit, në mbështetje të konceptit të votimit të lëvizshëm është një parim i drejtë. Megjithatë, dispozitat për një votim të lëvizshëm janë shpesh të shkruara në mënyrë të tillë që i bëjnë ato objekt abuzimi dhe mashtrimi.

Në rast se votimi i lëvizshëm lejohet nga kuadri ligjor, atëherë natyrisht është e mundur për analistin të bëjë rekomandimet e mëposhtme për të ruajtur integritetin e procesit të votimit të lëvizshëm:

- Ekzistenca e një procedure për identifikimin e zgjedhësive që do të përdornin lehtësitë e votimit të lëvizshëm për të evituar votimin e dyfishtë.
- Përdorimin e votimit të lëvizshëm vetëm në rastet kur zgjedhësi është fizikisht i pamundur të udhëtojë deri në qendrën e votimit për të votuar. Ky fakt duhet të përcaktohet nga zgjedhësi, duke i paraqitur, kur është e mundur, komisionit të qendrës së votimit një kërkesë me shkrim ku të shpjegojë arsyet përse është për të fizikisht e pamundur për të udhëtuar. Kërkesa duhet të dorëzohet nga zgjedhësi dhe të shqyrtohet nga komisioni i qendrës së votimit brenda afateve të përcaktuara me ligj.
- Lejimi i vëzhguesve të të gjitha kategorive, ose përfaqësuesve të tyre kur numri i vëzhguesve duhet të jetë i kufizuar për arsye praktike (p.sh. transporti me helikopter) të shoqërojnë kutinë e lëvizshme të votimit.
- Regjistrim zyrtar i numrit të fletëve të votimit të marra për t'u përdorur për votim të lëvizshëm dhe i numrit të fletëve të votimit të kthyer në përfundim të këtij votimi.
- Përputhje të numrit të fletëve të votimit të marra me numrin e kërkesave të paraqitura, plus një numri të vogël të caktuar fletësh votimi shtesë për rastet kur zgjedhësit mund të dëmtojnë fletë votimin e tyre.
- Regjistrimi në procesverbalin e qendrës së votimit dhe në ato vijuese i numrit të personave që kanë përdorur kutinë lëvizëse të votimit. Kjo lejon identifikimin e zonave të veçanta ku proporcioni i votave të hedhura në kutitë lëvizëse të votimit është jashtëzakonisht i lartë, gjë që mund të tregojë mundësinë e mashtrimit me votën.
- Administrim i përbashkët i votimit të lëvizshëm brenda territorit gjeografik që mbulon një qendër votimi nga të paktën dy anëtarë të komisionit të qendrës së votimit.

## D. Votimi i Forcave Ushtarake

Është e zakonshme dhe e pranueshme që një kuader ligjor të ketë dispozita të veçanta që garantojnë të drejtën e një anëtari të forcave ushtarake për të votuar ndërkohë që ai është në detyrë aktive. Megjithëse mbrojtja e të drejtës së votës për një pjesëtar të forcave ushtarake është me vend, këto dispozita duhen formuluar me kujdes pasi votimi nga ushtarakët mund të jetë objekt abuzimi.

Zakonisht, për zgjedhësit ushtarakë, kuadri ligjor lejon ngritjen e qendrave të posaçme të votimit brenda njësave ushtarake të vendosura në zona larg qendrave të banimit. Ndërsa një dispozitë e tillë mund të jetë e pashmangshme, ajo duhet të përcaktojë shprehimisht që përbën një rast përjashtimor dhe se kur është e mundur, zgjedhësit ushtarake duhet të votojnë në qendra civile të zakonshme votimi.

Gjatë zgjedhjeve vendore, normalisht një pjesëtar i forcave ushtarake duhet të votojë për zonën zgjedhore të vendbanimit të tij përhershëm.

## E. Balancimi i kushteve të përshtatshme për zgjedhësit me masat kundër votimit mashtrues

Krijimi i kushteve për zgjedhësit në votim duhet të balancohet me nevojën për marrjen e masave kundër votimit mashtrues. Në qoftë se nuk është hartuar me kujdes, një dispozitë që rregullon nevojat e një grupi të caktuar zgjedhësish nëpërmjet procedurave përjashtimore të votimit, atëherë mund të keqpëdoret nga persona që përpiqen të votojnë më shumë se një herë ose që nuk plotësojnë kërkesat ligjore për një procedurë përjashtimore votimi. Kështu, dispozita të tilla duhet të vlerësohen me vëmendje. Analisti duhet të krijojë bindjen se kuadri ligjor parashikon siguri të mjaftueshme për të penguar abuzimin dhe mashtrimin në rastet kur lejohen metoda alternative votimi.

### LISTË KONTROLLI E ANALISTIT PËR PROCEDURAT E VOTIMIT

- ✓ A garanton kuadri ligjor një votim të fshehtë? A ka dispozita ndaluese të përshtatshme kundër “votimit familjar”?
- ✓ A kërkon kuadri ligjor që zgjedhësit të identifikohen si duhet përpara se të marrin fletën e votimit?

- ✓ A përmban kuadri ligjor siguri të mjaftueshme për të mos lejuar votimin mashtrues apo të dyfishtë?
- ✓ A përmban kuadri ligjor dispozita të mjaftueshme për sigurimin e të gjitha fletëvetë votimit dhe materialeve zgjedhore para, gjatë dhe pas votimit?
- ✓ A parashikon kuadri ligjor metoda alternative votimi për persona të caktuar apo kategori të posaçme personash?
- ✓ A pengon kuadri ligjor një person të përdorë një metodë alternative votimi krahas një procesi të rregullt votimi në të njëjtat zgjedhje?



### XIII.

## TRANSPARENCA NË NUMËRIMIN DHE PROTOKOLLIMIN E VOTAVE

**OBJEKTIVI:** Kuadri ligjor duhet të sigurojë që të gjitha votat janë numëruar dhe pasqyruar në mënyrë të saktë, të barabartë, të ndershme dhe transparente.

#### A.

### Parimi i Përgjithshëm

Një numërim i drejtë dhe i ndershem i votave është gur themeli për zgjedhjet demokratike. Ilustrim i këtij standarti minimal është Paragrafi 7.4 i Dokumentit të OSBE-së, Kopenhagen 1990, i cili kërkon që votat “të numërohen dhe të raportohen ndershmërisht në rezultatet zyrtare të publikuara.” Kjo kërkon që votat të numërohen dhe protokollohen në prani të vëzhguesve dhe që i gjithë procesi deri në përcaktimin e një fituesi duhet të jetë krejtësisht transparent. Kuadri ligjor duhet të parashikojë praninë e vëzhguesve, vendas dhe të huaj, të përfaqësuesve të medias, partive politike dhe kandidatëve, gjatë numërimit dhe protokollimit të rezultateve të votave.

Kuadri ligjor duhet të shprehë qartë formulën zgjedhore që do të përdoret për kthimin e votave në mandate. Pragjet, kuotat dhe hollësira të tjera të formulës zgjedhore duhet të shprehen qartë si dhe të trajtojë gjitha rastet, si barazim votash, dorëheqje, apo vdekje e një kandidati. Ligji duhet të përcaktojë qartë votat e vlefshme dhe votat e pavlefshme. Rregullat për të përcaktuar vlefshmërinë e votave nuk duhet të jenë aq shtrënguese sa t'i heqin një zgjedhësi të drejtën e votës në mënyrë të paarsyeshme. Parimi kryesor që duhet ndjekur është se kur vullneti i një zgjedhësi shprehet qartë, vota e tij duhet numëruar. Për shembull, në rast se një zgjedhës rrethon zgjedhjen e tij dhe nuk vendos një kryq ngjitur me të, kjo nuk e bën votën të pavlefshme. Para votimit, ligji duhet të përcaktojë qartë se cilat vota konsiderohen të vlefshme dhe se si ato kthehen në mandate.

#### B.

### Numërimi i Votave

Pavarësisht nëse votat numërohen në qendrën e votimit apo në një qendër tjetër qendrore për numërimin e votave, ato duhet të numërohen në prani të vëzhguesve. Kuadri ligjor, përveç sigurimit të pranisë së vëzhguesve gjatë numërimit të votave, duhet

të garantojë gjithashtu siguri në rastet kur përdoret teknologjia dhe kur votat nuk numërohen me dorë. Kuadri ligjor duhet të përmbajë dispozita për të lejuar mundësinë e verifikimit të pavarur të saktësisë dhe besueshmërisë së aparaturave dhe programit të përdorur, në rastin e numërimit elektronik të votave. Pavarësisht nëse numërimi i votave është bërë në mënyrë manuale, mekanike apo elektronike, procedurat për verifikimin dhe inspektimin duhen bërë për të garantuar saktësi dhe besueshmëri. Gjithashtu duhet të ekzistojnë procedura që lejojnë kundërshtimin e procedurave të numërimit, përfshirë kundërshtimin e kriterëve të përdorura për përcaktimin e vlefshmërisë së votes.

Kuadri ligjor duhet të përcaktojë qartë se vëzhguesit mund të bëjnë kopje, ose duhet t'u jepen kopje të të gjitha procesverbaleve, tabelave të rezultateve. Ligji duhet gjithashtu të shprehë qartë se cilat autoritete qeveritare, nëse ka të tillë, janë ngarkuar ta marrin këtë informacion para vërtetimit të rezultateve zgjedhore nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

## **C. Nxjerrja e Rezultateve**

Kuadri ligjor duhet të shprehë me një gjuhë të qartë dhe objektive procedurat për transferimin e rezultateve të procesverbaleve të numërimit të votave, të fletëve të votimit dhe të materialeve zgjedhore nga komisionet zgjedhore më të ulëta në ato të nivelit të mesëm dhe të lartë për nxjerrjen e rezultateve dhe ruajtjen e tyre. Ligji duhet të kërkojë që të gjitha pasqyrat e rezultateve të hidhen në tabela apo në formate të ngjashme me to për t'i lejuar vëzhguesit të ndjekin rezultatet në secilën qendër numërimi apo votimi, në të gjitha nivelet e mbledhjes së rezultateve deri në daljen e rezultateve përfundimtare. Tabelat duhet të përmbajnë informacion të hollësishëm, përfshire numrin e fletëvotimeve të përdorura dhe të papërdorura, numrin e fletëve të votimit të pavlefshme dhe numrin e votave për çdo parti politike apo kandidat. Ky informacion duhet gjithashtu të detajohet për metodat alternative të votimit, si votimi me postë apo votimi i lëvizshëm. Kjo shkallë detajimi është e nevojshme pasi mundëson vëzhguesit të ndjekin rezultatet dhe të përcaktojnë me saktësi ku ka patur mashtrim nëse numrat janë ndryshuar në mënyrë të paligjshme gjatë proceseve të nxjerrjes së rezultateve.

Është gjithashtu shumë e rëndësishme një ndarje e përcaktuar qartë midis organeve për administrimin e zgjedhjeve dhe autoriteteve shtetërore në procesin e klasifikimit të rezultateve. Legjislati zgjedhor duhet të theksojë parimin se vetëm anëtarët e komisionit zgjedhor duhet të angazhohen në procesin e nxjerrjes së rezultateve zgjedhore. E rëndësishme është gjithashtu që vëzhguesve t'u jepen mundësi të ndjekin të gjitha fazat e procesit të numërimit dhe nxjerrjes së rezultateve.

## **D. Shpallja dhe Publikimi i Rezultateve**

Kuadri ligjor duhet të shprehë qartë nëse autoritetet zgjedhore duhet të njoftojnë rezultatet e pjesshme apo paraprake para vërtetimit të tyre përfundimtar. Në rast se rezultatet mund të njoftohen para vërtetimit të tyre përfundimtar, atëherë kuadri ligjor duhet të rregullojë qartë procesin për bërjen e këtyre njoftimeve.

Kuadri ligjor duhet të kërkojë që të *gjitha* dokumentet që lidhen me zgjedhjet të jenë në dispozicion të publikut, përfshirë këtu procesverbalet e zgjedhjeve dhe tabelat e rezultateve si dhe vendimet që përcaktojnë apo ndikojnë në rezultatin e zgjedhjeve. Këto dokumente zgjedhore duhet të afishohen publikisht në të *gjitha* nivelet e administratës zgjedhore, si në nivelet e komisioneve të qendrës së votimit, të bashkisë ashtu dhe në komisionin shtetëror të zgjedhjeve. Tabela të hollësishme për rezultatet përfundimtare, përfshi këtu edhe rezultatet e votimit në çdo qendër votimi, duhet të afishohen në çdo komision zgjedhor. Këto tabela të detajuara duhet gjithashtu të botohen në median e shkruar, të zotëruar apo kontrolluar nga shteti, menjëherë sapo të dalin rezultatet përfundimtare.

Mashtrime mund të ndodhin lehtësisht kur kuadri ligjor nuk kërkon afishimin publik të numërimit dhe nxjerrjes të votave në çdo nivel ku kryhet. Mundësia e mashtrimit ekziston kur një komisioni të nivelit të mesëm nuk i kërkohet të afishojë publikisht tabelat e rezultateve. Analisti duhet të vlerësojë me kujdes dispozitat ligjore që rregullojnë numërimin e votave dhe nxjerrjen e rezultateve.

## **E. Përcaktimi i Datës së Saktë për Nxjerrjen e Rezultateve Përfundimtare**

Kuadri ligjor duhet të përcaktojë qartë datat për nxjerrjen përfundimtare të rezultateve të zgjedhjeve, mënyrën sesi kryhet procesi i vërtetimit përfundimtar të këtyre rezultateve, përfshirë njoftimin publik, njoftimin e kandidatëve për zgjedhjen e tyre si dhe mandatet e kandidatëve të zgjedhur. Përveç kësaj, ligji duhet të shprehë qartë në cilat rrethana kërkohet një rinumërim apo zgjedhje të reja në ndonjë apo në të gjitha qendrat e votimit. Ligji duhet të shprehë qartë se kujt mund t'i kërkohet një rinumërim apo zgjedhje të reja, afati për bërjen e kërkesës si të gjitha procedurat e nevojshme në lidhje me të, afati i gjykimit të kërkesës së paraqitur, si dhe datën e procedurat që rregullojnë rinumërim e votave apo zhvillimin e zgjedhjeve të reja.

Kuadri ligjor duhet të garantojë një ruajtje të sigurtë të të gjitha fletë të votimit dhe materialeve zgjedhore deri në përfundim të afatit për paraqitjen e kundërshtimeve ligjore për rezultatet e nxjerra.

## F. Përrjashtime në lidhje me Sigurinë Personale

Në rrethana të jashtëzakonshme, botimi i rezultateve zgjedhore në nivelin e qendrës së votimit mund të rrezikojë sigurinë e zgjedhësve apo anëtarëve të komisionit zgjedhor në atë bashkësi. Kjo mundësi ekziston atje ku zgjedhjet zhvillohen pas një konflikti civil dhe ku tensioni mbetet ende i lartë. Analisti duhet të jetë i ndjeshëm në këtë çështje dhe të kuptojë se në kushte të jashtëzakonshme, ligji mund të parashikojë përrjashtime të kufizuara nga këto parime, në mënyrë që siguria personale e zgjedhësit të mos rrezikohet.

### LISTË KONTROLLI PËR TRANSPARENCËN NË NUMËRIMIN DHE PROTOKOLLIMIN E VOTAVE

- ✓ A siguron kuadri ligjor që i gjithë procesi për numërimin dhe nxjerrjen e rezultateve kryhet në praninë e vëzhguesve?
- ✓ A është është e shprehur qartë formula zgjedhore për kthimin e votave në mandate?
- ✓ A parashikon kuadri ligjor verifikimin e pavarur të të gjitha pajisjeve elektronike dhe elementëve të tjera në proceset e numërimit dhe nxjerrjes së rezultateve atje ku përdoren metoda të tjera, të ndryshme nga numërimi me dorë?
- ✓ A lejon ligji që të gjitha procesverbalet e rezultateve të bëhen në format të tillë që të lejojë vëzhguesit të ndjekin rezultatet e çdo qendre votimi, në të gjitha nivelet e grumbullimit të tyre, deri në nxjerrjen e rezultateve përfundimtare?
- ✓ A lejon ligji që të gjitha tabelat e rezultateve të përmbajne informacion të hollësishëm mbi rezultatet e nxjerra për cdo metodë votimi?
- ✓ A kërkon ligji afishimin publik dhe botimin në median e shkruar të rezultateve të hollësishme nga niveli i qendrës së votimit deri në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve?

- ✓ A përcakton qartë ligji proceset për nxjerrjen përfundimtare të rezultateve të zgjedhjeve, njoftimin e kandidatëve dhe kohëzgjatjen e mandatit për kandidatët e zgjedhur?
- ✓ A janë shprehur qartë të gjitha kërkesat dhe procedurat për rinumërimin e votave?
- ✓ A janë shprehur qartë të gjitha kërkesat dhe procedurat për zgjedhje të reja?

## XIV.

# ZBATIMI I TË DREJTAVE ZGJEDHORE

**OBJEKTIVI:** Kuadri ligjor duhet të përcaktojë mekanizmat dhe zgjidhjet e efektshme për zbatimin e të drejtave zgjedhore.

Kuadri ligjor duhet të përcaktojë mekanizmat dhe zgjidhjet e efektshme për zbatimin e të drejtave zgjedhore. OSBE/ODIHR-i ka botuar udhëzues të plotë mbi mënyrën se si një kuadër ligjor duhet të trajtojë procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve zgjedhore. Këta udhëzues të botuar janë të plotë dhe analisti duhet t'u referohet atyre për ndihmë në rast shqyrtimi dhe vlerësimi se si kuadri ligjor parashikon zbatimin e të drejtave zgjedhore. Këta udhëzues përmenden në Shtojcë.

Analisti duhet të ketë gjithmonë parasysh se mbrojtja e të drejtës së votës është një element bazë i kuadrit ligjor. E drejta e votës është një e drejtë themelore e njeriut, ashtu sic është edhe e drejta për të vënë në vend një shkelje të së drejtës së votës. Kështu, kuadri ligjor për zgjedhjet duhet të përmbajë dispozita të hollësishme dhe të mjaftueshme në mbrojtje të të drejtave zgjedhore.

Kuadri ligjor duhet të shprehë qartë se kush lejohet të bëjë ankesa pranë komisioneve/organeve zgjedhore dhe/apo gjykatave për shkelje zgjedhore. Kuadri ligjor duhet të përcaktojë se çdo zgjedhës, kandidat dhe parti politike ka të drejtë të bëjë një ankesë pranë komisionit zgjedhor kompetent ose gjykatës kur ka ndodhur një shkelje e të drejtave zgjedhore. Ligji duhet të kërkojë që komisioni/organi përkatës zgjedhor apo gjykata të marrë vendim menjëherë. Gjithashtu ligji duhet të garantojë të drejtën për të kundërshtuar një vendim pranë një gjykate kompetente për shqyrtimin dhe gjykimin përfundimtar të çështjes së ngritur. Vendimi i instances së fundit gjyqësore duhet gjithashtu të merret menjëherë.

Analisti duhet të bindet se ligji parashikon afate të arsyeshme për shqyrtimin dhe zgjidhjen e një ankesë dhe për komunikimin e vendimit palës paditëse. Disa ankesa mund të zgjidhen menjëherë, të tjera mund të kërkojnë orë dhe disa të tjera mund të kërkojnë edhe ditë për t'u zgjidhur. Afatet duhet të lejojnë një shkallë fleksibiliteti, në varësi të nivelit të komisionit zgjedhor apo gjykatës dhe llojit të ankesës.

Megjithëse parimet e lartpërmendura janë standarte ligjore minimale që duhet të përfshihen në kuadrin ligjor, një vend duhet të ketë fleksibilitet në përcaktimin e strukturës ligjore të sistemit që do të zgjidhë konfliktet zgjedhore.

**LISTË KONTROLLI PËR ZBATIMIN E TË DREJTAVE ZGJEDHORE**

- ✓ A përcakton kuadri ligjor mekanizma dhe zgjidhje të efektshme për zbatimin e të drejtave zgjedhore?
- ✓ A shpreh qartë kuadri ligjor se kush mund të bëjë ankesë për shkelje të ligjit zgjedhor dhe cili është procesi i paraqitjes së ankesave?
- ✓ A siguron kuadri ligjor të drejtën për të kundërshtuar një vendim të komisionit zgjedhor pranë një gjykatë kompetente për shqyrtim dhe gjykim përfundimtar të çështjes së ngritur?
- ✓ A përmban kuadri ligjor afate të arsyeshme kohore për paraqitjen, shqyrtimin dhe marrjen e vendimit për një ankesë?

# SHTOJCË

## I. Burimet Kryesore për Standartet Minimale

### A. Kombet e Bashkuara

#### DEKLARATA UNIVERSALE E TË DREJTAVE TË NJERIUT

##### Neni 21

1. Kushdo ka të drejtë të marrë pjesë në qeverisjen e vendit të tij, drejtpërdrejt apo nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur lirisht.
2. Kushdo ka të drejtë të përdorë në mënyrë të barabartë shërbimet publike në vendin e tij.
3. Vullneti i popullit është themeli i autoritetit të qeverisë, ky vullnet duhet të shprehet në zgjedhje periodike dhe të vërteta, të cilat duhet të zhvillohen nëpërmjet të drejtës universale e të barabartë të votës dhe nëpërmjet votimi të fshehtë dhe procedurash të barazvlefshme votimi të lire.

#### KONVENTA NDËRKOMBËTARE PËR TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE

##### Neni 25

Çdo shtetas ka të drejtën dhe mundësinë, pa asnjë prej dallimeve të përmendura në nenin 2 dhe pa kufizime të paarsyeshme:

- (a) të marrë pjesë në drejtimin e punëve publike, drejtpërdrejt apo nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur lirisht;
- (b) të votojë e të zgjidhet gjatë zgjedhjeve periodike, të vërteta, me votim të përgjithshëm dhe të barabartë dhe me votë të fshehtë që sigurojnë shprehjen e lire të vullnetit të zgjedhësve;
- (c) të përdorë, në kushte të përgjithshme barazie, shërbimet publike të vendit të tij.



## B. Këshilli i Evropës

### PROTOKOLL Nr 1 I KONVENTËS EUROPIANE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE DHE LIRIVE THEMELORE TË NJERIUT

#### Neni 3

Palet e Larta Kontraktuese marrin përsipër të zhvillojnë zgjedhje të lira, në intervale të arsyeshme, me votim të fshehtë, në kushte që do të sigurojnë shprehjen e lirë të mendimit të popullit për zgjedhjen e legjislaturës.

## C. Organizata për Sigurimin dhe Bashkëpunimin në Evropë

### KARTA E PARISIT PËR NJË EVROPË TË RE – TAKIMI I KSBE-së (21 NENTOR 1990)

#### Të drejtat e Njeriut, Demokracia dhe Shteti i së Drejtës

Qeverisja demokratike bazohet në vullnetin e popullit, të shprehur rregullisht në zgjedhje të lira dhe të ndershme.

Kushdo ka të drejtë: (...) të marrë pjesë në zgjedhje të lira dhe të ndershme.

### DOKUMENTI I MBLEDHJES SË KOPENHAGENIT TË KONFERENCES MBI DIMENSIONIN NJERËZOR TË KSBE-së (29 QERSHOR, 1990)

- (5) [Shtetet pjesëmarrëse] deklarojnë solemnisht se midis atyre elementëve të drejtësisë që janë thelbësorë për shprehjen e plotë të dinjitetit të pandarë të njeriut dhe të të drejtave të barabarta dhe të patjetërsueshme të të gjitha qenieve njerëzore janë si më poshtë:
- (5.1) zgjedhje të lira që do të mbahen në intervale të arsyeshme me votim të fshehtë ose sipas një procedure të barazvlefshme votimi të lirë, në kushte që sigurojnë në praktikë shprehjen e lirë të mendimit të zgjedhësve në zgjedhjen e përfaqësuesve të tyre; ...
- (6) Shtetet pjesëmarrëse deklarojnë se vullneti i popullit, i shprehur lirisht dhe në mënyrë të drejtë, nëpërmjet zgjedhjeve periodike dhe të vërteta, është baza

e autoritetit dhe legjitimitetit të çdo qeverie. Për rrjedhojë, shtetet pjesëmarrëse do të respektojnë të drejtën e shtetasve të tyre për të marrë pjesë në qeverisjen e vendit, si drejtpërdrejt ashtu edhe nëpërmjet përfaqësuesve të zgjedhur lirisht prej tyre, nëpërmjet proceseve të ndershme zgjedhore. Ata njohin përgjegjësinë e tyre për të mbrojtur dhe ruajtur, në përputhje me ligjet e tyre, detyrimet e veta ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut si dhe angazhimet ndërkombëtare, rendin demokratik të vendosur lirisht nëpërmjet vullnetit të popullit nga veprimtaritë e personave, grupeve apo organizatave që janë të përfshira apo refuzojnë të heqin dorë nga terrorizmi apo dhuna që synojnë të përmbysin këtë rend ose atë të një Shteti tjetër pjesëmarrës.

- (7) Për të siguruar që vullneti i popullit të jetë themeli i autoritetit të qeverisë, Shtetet pjesëmarrëse:
- (7.1) do të mbajnë zgjedhje të lira në intervale të arsyeshme, ashtu siç përcaktohet nga ligji;
  - (7.2) do të lejojnë që të gjitha vendet në të paktën një nga dhomat e legjislaturës kombëtare, t'i nënshtrohen votimit të lirë popullor;
  - (7.3) do të garantojnë të drejtën universale dhe të barabartë të votës për shtetasit që kanë mbushur moshën madhore;
  - (7.4) do të sigurojnë që vota të hidhet në fshehtësi ose me procedurë të barazvlefshme votimi të lirë dhe që votat do të numërohen dhe pasqyrohen me ndershmëri në rezultatet zyrtare të publikuara;
  - (7.5) do të respektojnë pa diskriminim të drejtën e shtetasve për të kërkuar funksione politike apo publike, si individë ose si përfaqësues të partive politike apo organizatave;
  - (7.6) do të respektojnë të drejtën e individëve dhe grupeve për të krijuar lirisht partitë e tyre politike apo organizata të tjera politike dhe do t'u sigurojnë këtyre partive dhe organizatave politike garancitë ligjore të nevojshme për t'i lejuar që ata të konkurojnë me njëri-tjetrin mbi bazën e trajtimit të barabartë përpara ligjit dhe autoriteteve;
  - (7.7) do të sigurojnë që ligji dhe politika shtërore të kontribuojnë që fushatat politike të zhvillohen në një atmosferë të ndershme dhe të lirë, në të cilën as veprimet administrative, as dhunë apo kanosa, të mund t'i ndalojnë partitë dhe kandidatët të paraqesin lirisht opinionet dhe cilësitë e tyre, ose mund t'i pengojnë

zgjedhësit të informohen rreth tyre, të diskutojnë ose të votojnë pa patur frikë nga ndëshkimi;

(7.8) do të kujdesen që asnjë pengesë ligjore ose administrative të mos pengojë përdorimin e lirë të mediave mbi bazën e mosdiskriminit për të gjitha grupimet politike dhe për të gjithë personat që dëshirojnë të marrin pjesë në zgjedhje;

(7.9) do të kujdesen që kandidatët që fitojnë numrin e nevojshëm të votave që kërkohet me ligj, të marrin rregullisht funksionet e tyre dhe të lejohen të mbeten në atë post deri sa mandati i tyre të skadojë ose të marre fund për çdo arsye tjetër në një mënyrë të rregulluar me ligj dhe në përputhje me procedurat demokratike parlamentare dhe kushtetuese.

(8) Shtetet pjesëmarrëse çmojnë se prania e vëzhguesve, si të huaj ashtu dhe vendas, mund të përmirësojë procesin zgjedhor në Shtetet ku zhvillohen zgjedhjet. Prandaj, ata i ftojnë vëzhguesit nga çdo shtet tjetër pjesëmarrës i KSBE-së dhe çdo institucion a organizatë private që mund të dëshirojë, të vëzhgojë zhvillimin e proceseve të tyre zgjedhore kombëtare, në masën që lejon ligji. Ata do të përpiqen gjithashtu të lehtësojnë një prani vëzhguesish edhe për zgjedhje të organizuara në një nivel më të ulët se ai kombëtar. Këta vëzhgues do të angazhohen se nuk do të ndërhyjnë në veprimet zgjedhore.

## II. Burime Plotësuese

Harris, Peter dhe Ben Reilly (eds.) 1998. Demokracia dhe Konflikti i Rrënjosur Thelle: Opsionet për Negociatorët. Stokholm: Instituti Ndërkombëtar për Demokraci dhe Asistencë Zgjedhore.

Petit, Denis. 2000. Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve Zgjedhore në Zonën e OSBE-së: Drejt një Sistemi Standart Monitorimi të Mosmarrëveshjeve Zgjedhore. Varshavë: Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut.

Reynolds, Andrew dhe Ben Reilly. 1997. Manual i International IDEA mbi Skemën e Sistemit Zgjedhor. Stokholm: Instituti Ndërkombëtar për Demokraci dhe Asistencë Zgjedhore.

Manual i ODIHR për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (Botimi 4). 1999. Varshavë: Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut.

### **III. Kodet Model**

Kodi i Sjelljes për Partitë Politike: Fushata në Zgjedhjet Demokratike. 1999. Stokholm: Instituti Ndërkombëtar për Demokraci dhe Asistencë Zgjedhore.

Kodi i Sjelljes për Vëzhgimin Etik dhe Profesional të Zgjedhjeve. 1996. Stokholm: Instituti Ndërkombëtar për Demokraci dhe Asistencë Zgjedhore.





Office for Democratic Institutions and Human Rights  
Al. Ujazdowskie 19  
00-557 Warsaw  
Poland

Tel.: (48 22) 520 06 00  
Fax: (48 22) 520 06 05  
E-mail: [office@odihr.pl](mailto:office@odihr.pl)  
<http://www.osce.org/odihr>